



PROFETI

Muhammed a.s

MIRËSI E MADHE PËR NJERËZIMIN



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXX i botimit
Nr. 10 (465)
Tetor, 2021

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Profeti Muhamed (a.s.), mirësi e madhe për njerëzimin / Redaksia

6 Dita që lindi Profeti Muhamed / Mehmet Disha

8 Lajme / Aktivitete



12 Ji i kënaqur me caktimin e Zotit / Qani Sulku

14 Islami dhe moderniteti kapitalist / Stefan Pacovski

16 Ngritja edukative e nxënësit të Kur'anit 2 / Dr. Zeglul Nexhar

20 Mbi debatin rreth mevludit / Erjol Haxhiu

22 Njeriu që nuk e ndryshoi dot bota, Ebu Ubejde bin Xherrah (r.a) / Tauland Bica

24 Durimi është dritë / Pim.dr.med.sc. Alf. Ilazi



26 Hoxhe Kadri Prishtina

30 Medreseja e Tiranës - një shekull për arsimin e diturinë / Intervistë

34 Fatime Zehra, model i vajzës, gruas dhe nënës myslimane / Dorian Demetja

36 Zhvillimi i trurit gjatë adoleshencës / Erion Sukaj

38 Faleminderit zoti im...





Profeti Muhamed (a.s.)

MIRËSI E MADHE PËR NJERËZIMIN

Në sajë të "dritës", që Zoti e krijoi në cilësinë e një dielli dhe që e zbriti si një kandil në qiellin e njerëzimit, të gjitha errësirat e injorancës u grisën dhe gjithësia u përfshi nga ndriçimi. Kjo "dritë" është mirësia më e gjerë e Zotit për xhindet e njerëzit. Që kjo është kështu, na e thotë vetë Zoti ynë në Kur'an: **"Allahu u ka bërë një dhuratë të madhe besimtarëve duke u dërguar nga mesi i tyre një peygamber, që t'u lexojë shpalljet e Tij, t'i pastrojë (nga të këqijat, nga mëkatet) dhe t'ua mësojë Librin dhe urtësinë..."**¹

Profeti Muhamed a.s. është profeti i fundit që Allahu i dërgoi njerëzimit. Ai është njeriu më i lartë, më me vlerë dhe më i respektuari nga të gjitha krijesat e tjera. Ai është profeti i mëshirës dhe i dashurisë. Allahu e dërgoi atë si mëshirë për gjynahqarët e të devotshmit, për gratë e fëmijët, për besimtarët e mohuesit, për njerëzit e xhindet. Madje, Allahu praninë dhe ekzistencën e Muhamedit a.s. në tokë, e bëri garanci dhe siguri për të gjitha krijesat, kur thotë: **"Ne të dërguam ty veçse mëshirë për botët"**².

Kush nis të kërkojë në shkrimet e shenjta, gjen se qëllimi më i madh i tyre është mëshira, njohja e njëri-tjetrit, ruajtja e marrëdhënieve etj. Kur'ani Famëllartë dhe suneti i Profetit janë ftesë e hapur për largimin e përcarjeve, urrejtjes dhe smirës. Në shpalljen hyjnore Allahu lavdëron mëshirën dhe butësinë. Ai në Kur'anin Famëllartë thotë: **"Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje"**³. Kur lexojmë me kujdes jetën e Profetit a.s., del në pah ana e tij e butësisë, faljes dhe mëshirës. Po të na shohësh sot, nëse krijojmë armiqësi me dikë, nuk lëmë vend për paqe e afrim, e as shans për bisedim, por i presim të gjitha mundësitë e mëshirës dhe shkatërrojmë të gjitha urat e bashkëbisedimit dhe faljes. Kush sheh shoqërinë tonë, gjen se ne jemi të ashpër me njëri-tjetrin, jemi të ashpër me ata që kemi kontradikta, nuk jemi të drejtë kur gjykojmë, veprojmë pa menduar, nëse nuk na pëlqen mendimi sulmojmë të zotin e tij pa kufi. Sikur u kërkohet njerëzve që të bien dakord me ne për gjithçka, të na e bëjnë qejfin për gjithçka, sikur mendimet tona të ishin shpallje hyjnore dhe sikur e drejta të na shoqëronte kudo. Në legjislacionin islam, ka ura bashkëpunimi dhe

afrimi më shumë nga ç'mund të përshkruhet. Ne jemi të mëshirshëm e të mirë me vetet tona, lavdërojmë çdo gjë që bëjmë, justifikojmë çdo gabim tonin, e mbrojmë veten prej çdo veprimi, kurse nga ana tjetër gjykojmë gabimet e të tjerëve, qortojmë me të madhe çdo gabim të tjetrit, e nganjëherë s'e pranojmë pendimin, e aq më pak justifikimin e tyre.

Nuajmani pinte ndonjëherë dhe i dërguari i Allahut zbatonte atëkohë ndaj tij distancimin. Veprimi i personit ishte një mëkat. Por, kur sahabët iu drejtuan atij me fjalë të rënda për shkak të këtij veprimi, Profeti vrenjti vetullat dhe urdhëroi: "Mos e ndihmoni shejtanin kundër vëllait tuaj. Betohe në Allah, se ai e do Zotin dhe të dërguarin e Tij"⁴. Sado mëkate të bëjë njeriu, tek i cili dashuria për Allahun dhe Profetin jep si rezultat bashkimin e tij me ta, nuk e meriton fjalën e keqe, sepse, në fund të fundit, ai e do Allahun dhe të dërguarin e Tij.

Duke qenë se Profeti a.s. është krijesa më e dashur tek Allahu xh.sh., ashtu duhet të jetë edhe për ne që pretendojmë se ndjekim rrugën e tij. Dashuria për profetin a.s. është njëkohësisht dhe dashuri për bukurinë dhe fisnikërinë e karakterit të tij, për drejtësinë, modestinë dhe forcën e brendshme të njeriut dhe që profeti e zotëroi në shkallën më të lartë. Myslimanët obligohen që dashurinë ndaj tij ta vendosin mbi dashurinë ndaj çdo krijese tjetër, përfshi këtu veten dhe të dashurit e tyre. Për këtë, në hadithin e transmetuar nga Enesi r.a., Profeti a.s. ka thënë: "Askush prej jush nuk do të jetë besimtar i vërtetë, derisa të bëhem për ju më i dashur se prindërit tuaj, fëmijët tuaj dhe të gjithë njerëzit e tjerë."⁵

Jetesa e Profetit a.s. nga njëra anë na nxit të lakmojmë arritjen e përsosmërisë dhe nga ana tjetër na ndihmon të pranojmë paaftësinë tonë për të qenë të pagabueshëm duke na shtyrë të jetojmë në paqe me veten si robër të penduar të Zotit, me shpresë në mëshirën e madhe të Tij. Që besimi ynë të jetë i shëndoshë dhe i plotësuar, duhet ta duam Profetin tonë duke ndjekur rrugën e tij dhe duke u lutur për të sipas urdhrit kuranor, mbështetur në ajetin 56 të sures Ahzab: **"Padyshim që Allahu e bekon të dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O ju që keni besuar, lutuni për të dhe përshëndeteni me salam"**.

1. Al-Imran, 164

2. Enbija, 107

3. Al-Imran, 159

4. Buhariu

5. Buhariu-Muslimi

DITA QË LINDI

Profeti Muhamed a.s



Ndodhitë e mrekullishme që nisën të ndodhnin në kohën e lindjes së Profetit nuk ishin të kufizuara vetëm brenda shtëpisë. Edhe në qiell po ndodhnin gjëra të çuditshme. Në Mekë jetonte një dijetar që merrej me shkencën e yjeve. Natën që lindi Profeti, atij i kishte bërë përshtypje një yll i ri, të cilin nuk e kishte parë kurrë më parë. Në mëngjes ai filloi t'u zinte rrugën Kurejshëve duke i pyetur:

- A ju ka lindur mbrëmë ndonjë djalë në lagjen tuaj?

- Nuk e dimë, - i thoshin ata.

- Atëherë shkoni menjëherë dhe pyesni, - i porositi ai, - sepse dje kam parë yllin e lindjes së profetit të fundit të njerëzimit. Në shpinë ai ka një shenjë që i takon pikërisht profetit të fundit.

Kurejshët pyetën gjithandej dhe u kthyen përsëri te dijetari hebre duke i thënë:

- Dje ka lindur djali i Abdullahut, madje e ka edhe shenjën që ju na treguat.

Hebreu që nuk donte t'u besonte veshëve, deshi të shkonte e ta shikonte këtë fëmijë me sytë e tij. U bë si i çmendur kur e pa edhe shenjën me sytë e tij. U largua prej andej me vrap dhe bërtiste:

- Kurejshëve do t'u vijë një shtet i atillë, që zëri do t'i shkojë prej skajit të Lindjes deri në atë të Perëndimit. Profetësia iku prej hebrenjve. Iku.

Pas lindjes, lajmi i mirë iu dërgua edhe gjyshit të foshnjës. Abdulmutalibi, i cili gjendej në Qabe në atë kohë, me të dëgjuar këtë sihariq, rendi menjëherë drejt shtëpisë. E mori fëmijën në krahë dhe zuri ta puthte me dashuri. E mori fëmijën me gjithë djep dhe shkoi me të në Qabe për të falënderuar Allahun. Kur u kthye, nëna e Profetit, Amina, i tregoi për ëndrrën në lidhje me vendosjen

e emrit të fëmijës, ndaj dhe e quajti Muhamed fëmijën e saj.

Një tjetër ngjarje që ndodhi teksa po lindte Profeti ynë i nderuar, ishte edhe shkatërrimi i katërmbëdhjetë shtyllave të pallatit mbretëror të persëve. Kisra, mbreti i tyre, së bashku me popullin e tij, pritën agimin për të mësuar se çfarë kishte ngjarë gjatë asaj nate. Kur u zgjuan, panë se katërmbëdhjetë shtyllat e pallatit ishin rrëzuar. Kisra mendoi të thërriste tempullarët e tij që t'i shpjegonin se pse kishin ndodhur të gjitha këto. Sapo ishin mbledhur priftërinjtë, kur ia behu një lajmëtar. Ai kishte ardhur të lajmëronte se ishte shuar zjarri, të cilin e adhuronin persët dhe që kishte shekuj të tërë që nuk shuhej. Kisra, me sytë e zmadhuar prej çudisë, iu drejtua kryepriiftit:

- Ç'do të thotë të gjitha këto?

Kryepriifti, i cili së afërmi kishte parë një ëndërr, ktheu këtë përgjigje:

- Kam përshtypjen se në vendet arabe do të ndodhin ngjarje shumë të rëndësishme.

Pastaj, me të pyetur, ata gjetën një vend, ku mund t'i jepnin përgjigje gjithë këtyre gjërave që po ndodhnin. Ky ishte një magjistar sirian me emrin Satiha, i cili nuk kishte kocka dhe e kishte kokën shumë më sipër trupit të tij.

Përgjigja e tij ishte e qartë dhe e shkurtër:

- Do të nisë të zbrësë kumtim prej qiellit me ardhjen e profetit të fundit, ndërsa Perandoria Perse, pas Perandorit të XIV, do të fshihet nga historia.

Me të vërtetë, pas kësaj ndodhie kaluan plot gjashtëdhjetë e shtatë vjet. Për sa kohë që në krye të vendit ishte Kisra i katërmbëdhjetë, fjalët e Satihut dolën të vërteta dhe pa asnjë lloj mangësie.



1

PJESËMARRJA NË FORUMIN NDËRFETAR TË G-20

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në Forumin Ndërfetar të G-20, zhvilluar në Bolonja/Itali. "Koha për të shëruar – Paqja mes kulturave dhe mirëkuptimi mes feve", është quajtur Forumi Ndërfetar i G-20, i cili zhvilloi punimet në 12-14 shtator në Bolonja.

Pjesëmarrës në këtë forum ishin studiues, akademikë, teologë, drejtues komunitetesh fetare, politikanë dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare.

Gjatë këtij forumi u mbajtën rreth 40 sesione dhe evente të tjera të ndryshme, ndër të cilat mbajtën kumtesat e tyre rreth 250 folës nga fusha të ndryshme të interesit.

Krytari Spahiu ishte ndër përfaqësuesit që folën në këtë forum.

Gjatë kumtesës së tij, ai vuri theksin te bashkëjetesa fetare në Shqipëri, si dhe te roli i rëndësishëm që luan feja islame dhe besimtarët myslimanë në këtë aspekt.

Ndër të tjera, u përmendën edhe kontributi i fesë në proceset demokratike, arsim, edukim, etj.





2

KONFERENCA SHKENCORE “NJË SHEKULL NGA PËRKTHIM I KURANIT NGA ILO MITKË QAFËZEZI”

Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, i cili funksionon në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti konferencën shkencore me titull: “Një shekull nga përkthim i Kuranit nga Ilo Mitkë Qafëzezi”. Konferenca u mbajt në Prishtinë më 21 shtator 2021.

Në këtë konferencë shkencore, ndër shumë studiues dhe akademikë të ndryshëm nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, pjesëmarrës ishte edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Përkthimi i Kuranit nga Qafëzezi një shekull më parë, është një “guxim” i madh dhe kontribut gjithashtu po aq i madh, kjo nisur nga fakti i përkatësisë fetare të Qafëzezit.

Kjo nismë ishte një hap shumë thelbësor për sjelljen në gjuhën shqipe të Kuranit Famëlartë, Fjalës së Zotit.

Qëllimi i kësaj konference ishte sjellja dhe dhënia e vëmendjes së duhur një nisme të tillë, e cila në kushtet dhe kontekstin historik në të cilin ka ndodhur, nuk ka zënë vendin që i takon në historinë e literaturës shqipe.





3

AKTIVITET NGA ZYRA E GRUAS NË MYFTININË E BULQIZËS

Në kuadër të aktiviteteve fetare, Zyra e Gruas pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në bashkëpunim me Myftininë e Bulqizës, ka organizuar një program me gratë besimtare të kësaj myftinie.

"Njeriu si krijesa më e përsosur e Zotit (xh.sh.)", ishte fokusi i bisedës që përgjegjësjë e zyrës, znj. Fatma Karaj diskutoi me gratë e pranishme në takim.

- Zoti e ka krijuar njeriun në formën më të bukur dhe i ka vënë atij në shërbim gjithçka. Në këtë frymë duhet të jetë edhe qasja jonë ndaj njëri-tjetrit, ta duam e ta respektojmë njeriun për hir të Allahut.

Duhet të theksojmë se Islami ka shpallur barazinë në krijimin e burrit dhe gruas. Pozita e secilit përpara Zotit rritet ose ulet në bazë të devotshmërisë. Kur Muhammedi (a.s.) filloi të predikonte Islamin, fenë e së drejtës, sapo nisi të njoftonte njerëzimin, njeriu i parë që besoi ishte një grua, gjegjësisht shoqja e tij Hatixhja. Kështu, gruaja dhe burri janë krijesa të barabarta përpara Zotit (xh.sh.), e kjo duhet të jetë edhe qasja midis burrave dhe grave ndaj njëri-tjetrit për të qenë besimtarë të mirë e të drejtë, tha ndër të tjera znj. Karaj në bashkëbisedimin e saj me gratë besimtare të Bulqizës.

4

VIZITË NË AMBASADËN E MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE NË TIRANË

Kryetari i KMSH-së H. Bujar Spahi, së bashku me Myftiun e Tiranës z. Lauren Luli, Drejtorin e Vakf/Investimeve dhe Financës z. Edison Hoti dhe Këshilltarin e tij z. Xhemal Seferti, zhvilluan një vizitë kortezie në Ambasadën e Mbretërisë së Arabisë Saudite, Tiranë.

Vizita ishte në kuadër të kthimit të vizitës që Ambasadori Faisal Ghazi Hifzi, zhvilloi në KMSH në muajin gusht të këtij viti, kohë në të cilën sapo kishte marrë detyrën e tij në vendin tonë.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka një traditë të shkëlqyer bashkëpunimi me Mbretërinë e Arabisë Saudite, bashkëpunim që përcillet edhe nëpërmjet përfaqësive diplomatike në Tiranë.





5

VIZITË PUNE NË MYFTININË E VLORËS

Ditën e premte (e xhuma), me datë 2.10.2021, Kryetari i KMSH-së zhvilloi një vizitë pune në Myftininë e Vlorës. Ai u prit nga Myftiu i Vlorës, z. Armand Asllani, dhe imamët që shërbejnë në të gjitha xhamitë e kësaj myftinie.

-Detyra juaj është përhapja e mesazhit të paqes, përfaqësimi dinjitoz i kësaj feje dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, dhe në këtë drejtim do të keni mbështetjen time të pakursyer, tha ndër të tjera ai gjatë bisedës me myftiun dhe imamët.

Myftiu Asllani, pasi e falënderoi kryetarin për vizitën, bëri edhe një prezantim të punëve të kësaj myftinie. Kryetari Spahiu mbështet dhe inkurajon çdo përpjekje që i shërben rritjes së shërbimit fetar në Vlorë dhe çdo myftinie tjetër të Shqipërisë.

Gjatë kësaj vizite, kryetari u shoqërua nga Drejtori i Vakf/Investimve dhe Financës, z. Edison Hoti.



ZI I KËNAQUR ME CAKTIMIN E Zotit

Të gjithë jemi të vetëdijshëm dhe biem dakord se jeta e kësaj bote nuk është një fushë me lule. Na ka ndodhur që të përballemi me bela të ndryshme, të përjetojmë sëmundje që na kanë shkaktuar dhimbje dhe siklete për një kohë të caktuar. Jo vetëm kaq, por kemi shijuar edhe hidhësinë e humbjes, qoftë të njerëzve tanë të dashur, apo humbje të natyrave të tjera si psh: humbje pasurie, dështime në sfera dhe drejtime shumë të rëndësishme për ne. Allahu i vë në sprovë besimtarët që deklarohen si të tillë, për të nxjerr në pah nivelin e besimit të tyre ndaj përcaktimit të Tij. "Besimtar" nuk është thjesht një emër që mjaftohet me kaq, por jo. Për ta merituar këtë cilësi dalluese, patjetër që duhet ta argumentosh në praktikë dhe ta tregosh me vepra. Në fenë islame, besimtarët myslimanë nuk mjaftohen vetëm në teori. Teoria pa praktikë është si të

shkruarit në rërë, ku sapo kalon një dallgë e fuqishme fshin gjithçka dhe nuk lë asnjë gjurmë, duke sheshuar çdo sipërfaqe që prek.

Besimtarët e devotshëm dhe të sinqertë nuk lëkunden nga asnjë sprovë apo bela të kësaj bote, përkundrazi, mirëpresin me qetësi çdo gjë që i vjen prej Zotit të tyre. Ata tregohen të durueshëm, sepse i gëzon përgëzimi, i bërë publik në Kuran për durimtarët, të cilët Allahu i do dhe i shpërblen pa masë. Prandaj, për çdo gjë që i godet, ata nuk thonë asgjë tjetër përveç se: "Të Allahut jemi dhe tek ai do të kthehemi", ose "Nuk ka asnjë forcë apo fuqi tjetër pos Allahut". Po të mos kishte bela në këtë botë, nuk do kishte Xhenet në botën tjetër. Nëse nuk do ekzistonte durimi, nuk do ishte as edhe shpërblimi. Nëse nuk do kishte lodhje, nuk do kishte as rehati. Nëse nuk do kishte dështim, s'do kishte as sukses. Pra çdo gjë ka dy anë të

medaljes, ku herë na bie njëra anë e herë tjetra.

Në këtë dynja, jo çdo gjë është në dorën tonë. Ndodh që të jemi të dorëzuar para shumë fakteve dhe ndodhive, pavarësisht dëshirave tona. Allahu është ai që jep jetë dhe vdekje. Është ai që dikujt i jep fëmijë e dikujt jo. Dikujt i jep edhe vajza edhe djem, dikujt tjetër ose djem ose vajza. Nuk duhet ta prishim zemrën, por ta pranojmë të gëzuar çdo fat të përcaktuar nga i Madhi Zot. Ka njerëz që bëjnë sikur u shembet bota, kur u ndahet nga kjo jetë dikush shumë i dashur për ta. Manifestojnë sjellje hysterike dhe zemërohen me Zotin, apo të tjerë kur furnizohen nga Zoti vetëm me vajza, e konsiderojnë veten sikur janë të pafat apo fatzinj. Ndërhyjnë në punët e Zotit pa e pasur këtë të drejtë.

Allahu është i Dijshëm dhe Ai e di mirë se çfarë bën. Ai çdo gjë, e bën

me një përcaktim të qartë dhe jo rastësor, por me një urtësi, të cilën jo të gjithë njerëzit mund ta kuptojnë ashtu siç duhet. Caktimi i Zotit është aq i rëndësishëm, sa që ai renditet te shtyllat më kryesore të besimit Islam. Nëse nuk beson se çdo gjë që ndodh në këtë botë, ndodh me urdhrin e Zotit, atëherë besimi yt nuk është i plotë dhe ti ke nevojë të punosh fort me veten tënde, derisa ta bindësh 100 % për këtë fakt. Nëse dëshiron të bësh një jetë të qetë dhe të lumtur në këtë dynja, atëherë duhet t'i dorëzohesh caktimit të Allahut (qoftë ai i mirë apo i keq). Allahu, ky Zot kaq i Mirë nuk përcakton për robin e vet përveç se të mirë, pavarësisht se njeriut jo çdo gjë që i ndodh, i duket e mirë. T'i dorëzohesh Allahut në çdo përcaktim të Tijin për ty, është nga gradat më të larta të devotshmërisë dhe nga nivelet më të larta të besimit. Ata që e arrijnë ta bëjnë këtë, përjetojnë edhe lumturinë më të madhe në këtë botë, dhe patjetër që meritojnë të jenë të lumtur e të gëzuar edhe në botën tjetër, në Xhenet.

Çfarë të vjen prej Zotit, hapja derën dhe mirëprite. As unë as ti dhe asnjë nuk është më i mirë se profetët e Zotit. A mendon se jeta e tyre u shkoi vaj. Kurrsesi. Edhe ata patën sprova dhe bela nga më të vështirat, që ndoshta ne s'do kishim

forcën dhe fuqinë për t'i përballuar. Edhe atyre u vdiqën njerëzit e tyre më të dashur; edhe ata u sëmurën me sëmundje që i munduan për vite me radhë. Megjithatë, ata duruan duke shpresuar tek shpërblimi i Allahut. E njëjta frymë besimi dhe shprese duhet të na shoqërojë edhe ne në jetën tonë. Ne ashtu-ashtu, i dorëzohemi Zotit, përse të mos i dorëzohemi të kënaqur? Përdërisa nuk disponojmë forcë për ta ndryshuar atë që vet Zoti ka shkruar për ne, atëherë përse të mos i nënshtrohemi të përulur Allahut të Lartësuar?! Vetëm kështu, jeta jonë mund të ndryshojë pozitivisht dhe të marr atë kuptim që Allahu ka dëshirë për robërit e Tij besimtarë.

Besimi në përcaktimin e Allahut është një nevojë emergjente për këdo, në mënyrë që ta perceptojë jetën në konceptin e saj real. Vetëm kështu, ai do të përjetojë çdo vështirësi dhe sprovë më lehtë dhe më me qetësi. Fundja, për këtë kemi nevojë. Kështu që, nuk duhet të urrejmë asgjë, të cilën Allahu zgjedh për ne dhe për jetën tonë, sepse aty ku mendojmë se është e keqe për ne, mund të fshihet një e mirë e madhe dhe anasjelltas. Allahu na pajistë me besimin e patundur dhe të fortë në përcaktimin e Tij! Amin



ISLAMI DHE MODERNITETI KAPITALIST

*Si kanë kërkuar myslimanët
t'u përgjigjen sfidave?*

Moderniteti kapitalist u shfaq në Perëndim nga një e kaluar konservatore dhe fetare. Shoqëria në Mesjetën e Perëndimit u ndikua shumë nga kisha dhe ligji feudal dhe u bazua në një ekonomi bujqësore (Kelley, 2002). Pas Rilindjes dhe Epokës së Iluminizmit të mendimtarëve të lirë dhe teoricienëve të rinj socialë, si Locke, Bentham e liberalë të tjerë, Perëndimi u shndërrua në mënyrë dramatike në një shoqëri tepër individualiste dhe kapitaliste. Vlen të përmendet se jo të gjithë bien dakord me atë se çfarë është moderniteti (McPherson, 2015). Disa nga vlerat që vijnë me modernizmin, siç janë kodet e veshjes dhe pirja e ligjshme e alkoolit, nuk përputhen me mënyrën se si shumë myslimanë praktikojnë besimin e tyre. Edhe kur mbështetet, kapitalizmi liberal ka qenë gjithmonë i pasigurt në botën myslimane, nga vendet ultra-konservatore në ato më liberale. Vizioni shoqëror i Locke për pronësinë e pronës përmes aplikimit të punës dhe shkëmbimit të produkteve (d.m.th. parimet e kapitalizmit) nuk janë të gjitha kundër parimeve ekonomike të Islamit. Islami lejon kapitalizmin e rregulluar me lejueshmërinë e bizneseve të vogla, shpërndarjen e pronës dhe tregtinë (Dunning, 2003). Sigurisht që ka ende kufij, siç është marrja me fajde, por problemi sot është se nuk ka asnjë vend apo shtet islam, por më tepër vetëm vende me shumicë myslimane, i cili është termi i preferuar nga shumë akademikë politikë myslimanë, siç është Tarik

Ramadan (2001). Pas kolonizimit perëndimor të shumë prej këtyre kombeve me shumicë myslimane, janë ngritur shumë strategji dhe përgjigje të ndryshme politike ndaj modernizmit kapitalist, qofshin ato në Perëndim apo në vendet myslimane që kanë miratuar parime sekular-liberale.

Islami politik lindi pas kolonizimit të Lindjes së Mesme nga kombet perëndimore, si Britania dhe Franca, dhe pas vendosjes së Izraelit, të mbështetur nga aleatët perëndimorë. Për më tepër, mbështetja e sundimtarëve autokratë në Lindjen e Mesme dhe ndërhyrja e vazhdueshme e Perëndimit në vendet myslimane, kanë siguruar që edhe pse kolonializmi fizik ka përfunduar, ai ende mbijeton në forma të ndryshme. Disa vende myslimane kanë hedhur poshtë plotësisht idealet perëndimore, të tilla si liberalizmi ose demokracia; këto përfshijnë Iranin e Khomeini (Rubin, 2003). Të tjerët kanë refuzuar mënyrën perëndimore të jetës, por lejuan tregtinë me Perëndimin dhe lejuan disa parime kapitaliste. Këto përfshijnë Arabinë Saudite (Martin, 1982).

Si çdo lëvizje, Islami Politik ka dalluar pjesën e tij të mendimtarëve dhe shkrimtarëve. Sejfid Kutub shkroi gjerësisht, duke argumentuar kundër modernizmit dhe kapitalizmit që ka ndonjë vend në shoqëritë myslimane. Ai besonte se myslimanët, të cilët e mirëpresin modernizmin, po krijojnë një gjendje të "xhahilijes" (injurancës) dhe se ata po kryejnë kufr

(mosbesim), i cili ka dhënë lindjen e idesë shumë të rrezikshme dhe të politizuar të tekfirit (deklarimi i myslimanëve si jobesimtarë) (Terence & Dagger, 2009, f. 456-460).

Shumë lëvizje radikale, të tilla si Al-Kaeda, dhe udhëheqësi i tyre, Osama bin Laden, u ndikuan shumë nga kjo ide. Bin Laden shpesh shpjegonte ideologjinë e tij politike dhe ambiciet e tij për një shtet islam puritan, të lirë nga çdo ndikim perëndimor. Argumentet e tij, që justifikonin bombardimet e ndërtesave të ndryshme amerikane në botën myslimane, ose në tokën amerikane, nuk ishin aq të ndryshme nga argumentet e Kutub-it në mbështetje të një xhihadi global si një sulm ofensiv kundër modernizmit, kapitalizmit dhe idealeve të tjera perëndimore të cilat shihen (si) blasfemuese nga interpretimi i tyre i Islamit. Vëllazëria Myslimane, e cila u themelua në Egjipt në vitet 1920, ka qenë një lëvizje me ndikim konservator. Ata kërkuan rregull politik, duke njohur Kur'anin dhe Sunetin si e vetmja pikë referimi për rendin shoqëror. Vëllazëria Myslimane përfundimisht erdhi në pushtet në Egjipt pas Pranverës Arabe të vitit 2011 dhe përmbysjes së diktatorit të Egjiptit, Husni Mubarak. Sundimi i tyre nën udhëheqjen e Mursit shkaktoi shumë pakënaqësi midis atyre që nuk ndanin botëkuptimin e Vëllazërisë, dhe përfundimisht Gjenerali Abdel Fettah el-Sisi mori qeverinë pas një grushti shteti dhe premtoi të rikthente Egjiptin në një shoqëri laike.

Në një pjesë tjetër të botës myslimane, të shkatërruar nga lufta civile, Shteti Islamik erdhi në pushtet (Gerges, 2015). Edhe pse shumica e myslimanëve në të gjithë botën kundërshtojnë pretendimin e grupit për politikën islamike, IS beson fuqimisht se janë trashëgimtarë të ringjalljes së khalifatit islam. Para se të shkojmë më tej, është e rëndësishme të dimë se çdo grup politik islamik, qoftë militant apo jo, ëndërron të kthehet në një khalifat islamik. Filozofia politike e një khalifati islamik është qëllimi përfundimtar dhe vizioni shoqëror, çdo politikë që arrin atë qëllim është e vlefshme. Sigurisht ajo që është e nevojshme dhe ajo që nuk është, ndryshon nga grupi në grup. Ka grupe ekstreme që përdorin terrorizmin dhe faktorë të tjerë të frikës, të tilla si IS dhe Al-Kaeda, dhe grupe të tjera, të tilla si Vëllazëria Myslimane, duke përdorur demokracinë si një proces për të arritur pushtetin dhe zbatimin e khalifatit islamik. Ekzistojnë gjithashtu grupe islamike të tilla si Hizbu't-Tahrir, të cilët janë krejtësisht jo-militantë, por që propagandojnë mes myslimanëve globalisht, duke synuar të arrijnë kthimin e një khalifati islamik (Butt, 2010).

Ekzistojnë edhe zëra të moderuar politikë, në komunitetin mysliman, të cilët gjithashtu kanë një

strategji për t'u marrë me sfidat e modernitetit kapitalist. Sipas predikuesit dhe shkrimtarit të mirënjohur mysliman, Fethullah Gylen, sekularizmi nuk duhet parë si në kundërshtim me Islamin. Ai pranon se sekularizmi përfshin lirinë e fesë, duke shkruar: "Liria e fesë përcaktohet ashtu si individët të besojnë në fenë e zgjedhur prej tyre dhe pa frikën e shqetësimit për të qenë në gjendje të praktikojnë kërkesat e fesë që ata zgjedhën lirisht." (Ergil, 2015). Ai e sheh këtë si koherente me Islamin, pasi Kur'ani thotë se "nuk ka asnjë detyrim në fe". Ai gjithmonë ka besuar fuqimisht se feja nuk duhet të përdoret si një mjet i politikës, qofshin ata politikanë të krishterë apo politikanë myslimanë, të cilët kërkojnë të fitojnë pushtet politik.

Sejjed Hussein Nasr, një mendimtar i shquar mysliman, bën një kritikë të fortë të modernizmit, duke argumentuar se modernizmi do të thotë ajo "e cila është e prerë nga Transcendenca, nga parimet e pandryshueshme, që në të vërtetë qeverisin të gjitha gjërat dhe që i bëhen të njohura njeriut përmes shpalljes në kuptimin e saj më universal". Ky është një interpretim shpirtëror i modernitetit, i cili argumenton se Islami tradicional e hedh poshtë atë përkufizim të modernitetit që e sheh Islamin të përqendruar në spiritualitetin në këtë botë dhe jo materializmin, e cila është mënyra perëndimore e të jetuarit (Bilecen, 2014). Tarik Ramadan, një profesor i studimeve Islame në Universitetin e Oksfordit, i jep prioritet mendimin islam politik në krahasim me mendimin politik perëndimor. Ramadani pretendon se myslimanët, veçanërisht në Perëndim, duhet të jenë të pajisur për t'u përgjigjur në mënyrë të përshtatshme sfidave të modernitetit me një pikë referimi, duke u kthyer te idealet islame të etikës dhe shpirtërores (Ramadan, 2001). Ai argumenton se duhet të ketë një dialog kuptimplotë dhe intelektual midis myslimanëve dhe Perëndimit për të trajtuar modernitetin.

Shumë myslimanë kanë adoptuar jetesën në Perëndim nën sekularizëm dhe në një shoqëri kapitaliste, por akoma mbeten kritikë ndaj sfidave që të dyja paraqesin. Është gjithashtu e qartë se shumica e myslimanëve refuzojnë mizoritë që ndodhin në pjesë të izoluara të botës myslimane dhe të kryera nga disa myslimanë militantë, duke iu përgjigjur idealeve perëndimore të kapitalizmit dhe modernizmit që ata zakonisht i hasnin në formën e kolonializmit. Myslimanët dhe jomyslimanët ashtu kanë qenë kritikë për shekuj dhe kjo kritikë nuk duhet të shihet si një sulm ndaj shoqërisë, por përkundrazi duhet të përmirësojë shoqërinë dhe të hapë një dialog midis myslimanëve dhe jomyslimanëve.

Përshtati nga anglishtja Haki Sahitaj

NGRITJA EDUKATIVE E NXËNËSIT TË KUR'ANIT (2)



Plotësimi i ngritjes edukative të myslimanit në përgjithësi, dhe e hafizëttë Kur'anit Fisnik në veçanti, bazohet mbi konceptin e drejtë Islam ndaj njeriut, kozmosit, jetës dhe ndaj kuptimit të të qenët e Allahut xh.sh. Zot. Kjo mund të përmbledhet në pikat e mëposhtme:

4-Natyrshmëria e vlerave të njeriut

Vlera e e së mirës të njeriut dhe mjeti për zhvillimin e saj është nënshtrimi nëpërmjet adhurimit vetëm ndaj Allahut xh.sh. Kjo për arsye se në qoftë se njeriu nuk i nënshtrohet adhurimit ndaj Allahut, atëherë ai do të ishte një arrogant i fuqishëm në tokë, duke e përdorur çdo mirësi, të cilën ia ka dhuruar Allahu, në arrogancë dhe në bërjen ligësi në tokë, ose do të ishte rob jo për Zotin. Kjo është njëra prej formave të degradimit njerëzor, që është në kontradiktë me nderimin e Allahut ndaj bijve të Ademit. Atëherë, kush është më i denjë për Teuhidin - Unitetin - e Allahut se sa mbajtësi i Librit të Tij?!

Prej veçorive të Teuhidit të pastër të Allahut Krijues është që njeriu të besojë se nuk ka sovranitet në këtë ekzistencë, përveç sovranitetit të Allahut. Si rrjedhojë, adhurimi ndaj tjetërkujt, përveç Zotit, do të ishte degradim ndaj dinjitetit të njeriut dhe poshtërim ndaj humanizmit të tij. Kjo është njëra prej formave të shirkut - të përshkruarit ortakë Zotit - gjë të cilën e ka ndaluar Allahu, të cilën Muhamed Mustafaja e bëri prej gjynaheve të mëdha, prej shtatë gjynaheve shkatërruese. E mira e natyrshme të njeriut, në përgjithësi, dhe në mbajtësin e Kur'anit në veçanti, janë ato vlera më të mëdha mbi të cilat Allahu e krijoi njeriun. Prej atyre vlerave janë dashuria për të vërtetën, dashuria për të mirën, vlerësimi i bukurisë konkrete dhe abstrakte të krijesat këto janë reflektim i madhësisë së fuqisë krijuese dhe janë tregues e argument për Krijuesin e Madhërisë, i Cili është i Vërteti e i Miri dhe i Cili është Dhuruesi i të gjitha formave të bukurisë në mënyrë absolute. Allahu është burimi i të gjitha vlerave më të larta dhe pikërisht Ai është synimi i tyre.

Detyra e edukimit islam është që të ruajë natyrën e shëndoshë njerëzore, që të punojë për ta zhvilluar e pastruar atë në mënyrë të vazhdueshme dhe veçanërisht me hafëzin e Kur'anit Fisnik. Mësimdhënia pa edukim e pa pastrim është një mësimdhënie e mangët. Dhe ja! Prijësi ynë Ibrahim a.s, babai i profetëve, dhe djali i tij Ismaili a.s, i luteshin Allahut për pasardhësit e tyre duke thënë: "Zoti ynë! Ço nga mesi i tyre një të dërguar, i cili t'u recitojë atyre Librin dhe urtësinë dhe që t'i pastrojë ata. Vërtet që Ti je i Gjithëfuqishmi, i Gjithëurti". (Bekare, 2: 129)

5-Edukimi islam dhe shoqëria njerëzore

Individi është anëtar në një shoqëri, e cila vazhdon

të zgjerohet derisa të përfshijë të gjithë njerëzimin, duke përfshirë familjen e tij, të afërmit e tij, shoqërinë, vendin, umetin dhe të gjithë botën. Ai është i lidhur me të gjitha këto grupime nëpërmjet lidhjeve të ndryshme. Ai ka të drejta tek ata, ashtu siç ka edhe vetë ai detyrime ndaj tyre. Nuk drejtohet jeta në këtë dynja veçse me vendosjen e një ekuilibri të hollë e të saktë mes të drejtave të individit dhe detyrimeve të tij ndaj shoqërisë. Kjo është prej çështjeve që nuk mjaftohen vetëm me mësimdhënie, por duhet patjetër që të ngulitet tek individi nëpërmjet ushtrimit praktik dhe duke ndjekur shembullin e mirë, duke zbatuar urdhrat e Allahut dhe duke iu shmangur ndalesave të Tij xh.sh, duke qëndruar te limitet që Ai ka vendosur për marrëdhëniet e secilit prej tyre me të gjithë shoqërinë njerëzore, pavarësisht ndryshimit të saj, sidomos në qoftë se edukatori do të ishte prej hafëzve të Kur'anit Fisnik. Edukimi islam në këtë nuk do të mund të ishte një proces i ngushtë krahinor të cilin e përkufizojnë kufijtë e tokës, ose dallimet e gjuhës, ose ndryshimi i ngjyrës, ose dallimi i gjinisë. Ai edukim orvatet për ngritjen e njeriut të drejtë me të cilin do të ndërtohet shoqëria e drejtë njerëzore. Ajo shoqëri duhet, medoemos, të jetë një shoqëri e arsimuar e mendjemprehtë, në të cilën individi ta ndjejë kuptimin e vëllazërisë njerëzore, të krenohet me të, ta ruajë dhe ta mbrojë atë. Për më tepër, barazia, në mësimdhënien islame, mes elementeve të të gjithë llojit njerëzor, është një urdhër e detyrim. Në të nuk ka dallim të bardhit dhe të ziut, as mes mashkullit dhe femrës. Të gjithëve u kërkohet ta adhurojnë Allahun dhe ta kenë frikë Atë, dhe nuk ka adhurim pa dituri, pa udhëzim e pa angazhim.

6-Vëmendja ndaj dhuntive të ndryshme të individëve

Individët janë të ndryshëm në aftësitë, në dhuntitë dhe në talentet e tyre. Edhe sikur kjo të ishte si një sprovë a testim, veçse ky ndryshim mes individëve duhet, medoemos, të merret parasysh në procesin edukativ. Asnjë njeri nuk mund të ngarkohet mbi mundësinë e tij. Për këtë arsye, edukimi në Islam është një edukim individual, i veçantë, i cili nuk përkufizohet në kallëpe të unifikuar e të ngrirë, të cilëve u mungon natyrshmëria e tyre njerëzore, por ai i lihet mirëvlerësimi të edukatorit dhe aftësisë së tij për orientimin e dhuntive të veçanta të çdo studenti, dhe i lihet pranimit të studentit orientimi i edukatorit të tij nëpërmjet një lidhjeje të ndritshme, e cila i lidh ata të dy, baza e së cilës është frika prej Allahut dhe puna për Kënaqësinë e Tij xh.sh. Sa e bukur është kjo në rrethet e mësimi të Librit të Allahut!

7-Plotësimi i njohjes edukative

Burimet e njohjes janë Shpallja Qiellore, njohuritë dhe teknikat e fituara, dhe trashëgimia njerëzore e

transmetuar në këto dy fusha. Për më tepër, edukimi islam duhet, medoemos, ta marrë e ta sigurojë metodologjinë dhe përmbajtjen e saj prej secilës, prej Shpalljes Qiellore dhe prej trashëgimisë së njohurive dhe teknikave të fituara. Neglizhenca kundrejt secilës prej atyre të dyjave nuk mund të çojë në një njohje të plotë të dobishme dhe as në një edukim të shëndoshë. Si rrjedhojë, bëhet e domosdoshme që hafizi - ai që e ka mësuar përmendësh Kur'anin Fisnik - të familjarizohet me të dhënat e përgjithshme të shkencave derisa ai të mos jetë i veçuar e i ndarë prej shekullit të tij.

8- Shpallja Qiellore dhe efektet e saj edukative

Mjeti i njeriut për të njohja qiellore është Uahji - Shpallja Qiellore- mbi një numër pejgamberësh e të dërguarish; dhe ajo që u grumbullua, u plotësua dhe u ruajt në mesazhin e fundit, e përfaqësuar në Kur'anin Fisnik dhe në Sunetin e të Dërguarit të Fundit, Vulës së Profetëve. Allahu sigurisht që premtoi se do t'i mbronte Kur'ani dhe Suneti në shqip janë mashkullor, në mënyrë të plotë, në gjuhën e tyre (në Gjuhën Arabe) përgjatë katërmbëdhjetë shekujve të shkuar, dhe Allahu premtoi se do t'i ruante në mënyrë absolute derisa t'i bënte ato të dyja të mbeteshin vazhdimisht si argument për të gjithë njerëzit deri në ndodhjen e Kiametit. Këtu bëhet e qartë vlera e memorizuesit të Kur'anit Fisnik.

Për më tepër, besimi i njeriut në Mesazhin Qiellor është një kërkesë e domosdoshme prej domosdoshmërive të dërguesit të tij, madje prej domosdoshmërive të ekzistencës së tij.

A-Është prej kërkesave të domosdoshme të dërguesit të tij, sepse dituria e cila nuk mund t'u përgjigjet pyetjeve themelore në jetën e njeriut, të tilla si, Kush është Ai(.) i Cili e ka krijuar atë dhe e ka dërguar në këtë jetë? Si do të ishte e mundur që ai ta përmbushë atë mision në mënyrën më të mirë e shembullore? Ajo dituri do të ishte e mangët edhe sikur të arrinte me njeriun në Hënë, të udhëtonte me të në hapësirë, të shpërthente për të sekretet e atomit dhe të nënshtronte për të energjitë e tij të ndryshme.

B-Besimi në Shpalljen Qiellore është prej kërkesave të domosdoshme të ekzistencës së njeriut, sepse ai nuk do të mund të vendoste për veten e tij një sistem gjithëpërfshirës e të plotë(.) i cili do të organizonte jetën e tij dhe marrëdhëniet e tij si individ, si shoqëri, si shtete dhe si popuj dhe si një shoqëri e vetme njerëzore, mbi bazën e së drejtës, pa tendenca personale dhe as pa tekat e nefsit të tij, sado që t'i jepeshin njeriut prej shkaqeve të zgjuarsisë dhe të mendjemprehtësisë. Kjo për arsye se njeriu nuk mund t'i përcaktojë detajet e misionit të tij në këtë jetë dhe as të perceptojë fundin e tij, pas saj, vetëm nëpërmjet mendjes. Si rrjedhojë, theksohet domosdoshmëria e Mesazhit Qiellor, me qëllim që njeriu të udhëzohet nëpërmjet udhëzimit të

atij mesazhi në çështjet tek të cilat ai nuk mund të arrijë me përpjekjet e tij tek asnjë konceptim i saktë. Për këtë arsye, Allahu xh.sh dërgoi pejgamberë e të dërguar me fenë e Tij të vërtetë, dhe u kërkoi njerëzve që të besonin në këtë fe të vërtetë dhe ta vendosnin vendimin e Allahut në tokë mbi bazën e saj.

Mesazhi i fundit qiellor është ai që iu shpall Prijësit tonë Muhamedit a.s., të cilin Allahu e bëri Vulën e pejgamberëve dhe të të dërguarve; e bëri Kur'anin Fisnik më të madhen e mrekullive të tij; premtoi se do ta ruante Kur'anin, duke e mbajtur atë të sigurt pa u humbur, pa u ndryshuar dhe pa u modifikuar. Si rrjedhojë, edukimi në Islam ngrihet mbi bazën e Kur'anit Fisnik dhe të udhëzimit të tij, si dhe mbi bazën e mësimëve të të Dërguarit tonë fisnik a.s. dhe të Sunetit të tij, duke e lidhur këtë me realitetin e Umetit në çdo kohë e vend. Atëherë, kush do të ishte më i denjë për këtë se sa hafiz i Kur'ani Fisnik?

Për më tepër, interesimi i të parëve tanë - Selefus-Salih - prej myslimanëve për t'ua mësuar përmendësh Kur'anin Fisnik bijve dhe bijave të tyre që në moshë të re, ka qenë një punë themelore në edukimin e tyre. Me këtë u formuan besimi dhe moralet e tyre, u disiplinuan sjelljet dhe trajtimet e tyre, si dhe u realizuan thellësia e besimit të tyre dhe lidhja e tyre me Krijuesin e tyre. Me këtë u rrit perceptimi i tyre për misionin e tyre dhe me këtë perceptim ata dominuan botën dhe e mbushën atë me dituri, me drejtësi, me mëshirë e humanizëm. Me këtë ata u bënë të talentuar e profesorë në gjuhën e tyre, si dhe ruajtën mesazhin e Zotit të tyre, dhe kjo vazhdon akoma të jetë mënyra më e mirë për edukimin e myslimanit, pavarësisht kundërshtive që i erdhën dhe vazhdojnë t'i vijnë prej armiqve të Islamit dhe prej kundërshtarëve të tij ndaj asaj metode në edukimin e të vegjëlve. Kjo ndodh për arsye se mësimi përmendësh i Kur'anit Fisnik në moshë të re është i lehtë, meqë kujtesa në këtë moshë dallohet me pastërtinë e saj, duke e bërë të lehtë këtë proces.

Kur'ani Fisnik, përveç të qenët e tij një bibliotekë shkencore, fetare, gjuhësore, edukative, morale dhe etike, është një majë - kurorë - për mbajtësin e tij, saqë, edhe nëse nuk do të ishte plotësisht i vetëdijshëm për të në moshë të hershme, ajo sigurisht rritet me zhvillimin e tij mendor e fizik dhe mbetet për të një rezervë në dynjanë e tij, ashtu siç mbetet e tillë edhe në Ahiretin e tij.

Edukatorët sot kanë mendim unanim lidhur me faktin se fjalët dhe strukturat e fjalisë, të cilat i mëson përmendësh fëmija në gjatë fëmijërisë, janë nxitja më e madhe për zhvillimin e fëmijës mendërisht, ideologjikisht, moralisht si dhe nga aspekti i etikës bashkë me zhvillimin e aftësive të tij për shpjegim. A ka më elokuent se sa elokuenca e Allahut në Kur'anin Fisnik?

Shqipëroi nga Arabishtja: Jusuf Salkurti

19

MBI DEBATIN RRETH

Wavludlit

Duke qenë se jemi në muajin Rabiul Euel, muaj në të cilin ka lindur Profeti (a.s.), muaji i cili në trojet tona njihet si "muaji i mevludit", shikojmë se vit pas viti, njëra nga temat me të debatuar në rrjetet sociale dhe në ambientet e xhamive e të shkollave është, nëse lejohet që të festohet mevludi apo jo. Festimi i mevludit është nga punët të cilën brezat e parë nuk e kanë festuar, mirëpo kjo në vetvete nuk është argument për ta ndaluar festimin e mevludit, sepse në tekstet fetare gjejmë mjaft argumente të cilat dëshmojnë për lejimin e festimit të rastet e veçanta.

Të gëzohesh për një të mirë që të ka ndodhur, me rastin e lindjes së fëmijës, me rastin e martesës apo të diplomimit, janë nga ndjenjat më normale që e shoqërojnë një individ. Pikë së pari, fjala ditëlindje është përmendur në Kuranin famëlartë, po ashtu edhe në hadithet Profetike.

Kurani e përmend dhe e përshëndet ditën kur u lind Isai (a.s.): "Dhe selam (prej nesh) atij ditën kur u lind, ditën kur vdes dhe ditën kur do të ngrehet i gjallë (e përshëndetëm dhe i garantuam)!" (Merjem 15.)

Disa nga dijetarët mendojnë se festimi dhe gëzimi për ditëlindjen e Profetit Muhamed (a.s.) është qartësuar edhe nga ajeti 58 i sures Junus: "Thuaj: Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t'i gëzohen ...". Sipas komentatorëve të Kur'anit, mirësia më e madhe është dërgimi i Profetit (a.s.) dhe mëshirë për çdo gjë, pastaj gëzimi për ardhjen e Profetit (a.s.) është gjë e porositur.

Profeti (a.s.) kur ka folur për vlerën e ditës së xhuma, ka përmendur se njëra nga mirësitë e kësaj dite është lindja e Ademit (a.s.).

Gjithashtu, përmendet në "Sahihu'l Buhari" se Thuejbeh, një nga nënat e qumështit të profetit (a.s.) ka parë në ëndërr që Ebu Lehebi për çdo ditë të hënë i lehtësohej dënimi i zjarrit të Xhehenemit për arsye se, nga gëzimi, e kishte liruar robëreshën e tij, e cila e kishte informuar atë për lindjen e Muhamedit (a.s.), (Kitabun Nikah).

Në lidhje me këtë, Hafizi Dimeshki thotë:

**Kur për një jobesimtar të poshtëruar në Kur'an:
"qoftë i shkatërruar Ebu Lehebi,
në Xhehenem përjetë do të jetë ai",
na thuhet se çdo të hënë i lehtësohet dënimi
prej gëzimit që ka treguar për nipin e tij (Muhamedin a.s.).
Atëherë, nëse është kështu,
e si do të jetë çështja për besimtarin e devotshëm
i cili jeton i lumtur dhe vdes në njësim deri në përjetësi.**

Për lejimin e festimit të ditëlindjes së Profetit (a.s.), është argument edhe hadithi i transmetuar nga Muslimi se kur është pyetur Profeti (a.s.) pse agjëron ditën e hënë dhe të enjte, ai është përgjigjur duke thënë: "Se në këtë ditë (e hënë) kam lindur, dhe në këtë ditë ka filluar të më vijë shpallja", (Sahihu'l Muslim, kitabu Sijam). Po ashtu, këta përmendin atë se Profeti (a.s.) ka pre kurban për ditëlindjen e tij.

Në lidhje me këtë temë, përmbledhjen më të bukur e ka bërë Hafizi dhe dijetari i madh Ibni Haxher El Askalani.

El-Sujuti, Allahu e mëshiroftë, ka thënë:

Shejhul Islam, Hafizi i Shekullit, Ebul-Fadl bin Haxher u pyet për punën e Mevludit dhe u përgjigj me sa vijon:

"Në origjinë Mevludi është një risi (bidat), pasi nuk është transmetuar nga asnjë prej paraardhësve të mirë të Tre Brezave të Parë. Megjithatë, ai përfshin veprime të virtytshme dhe veprime të pavirtytshme. Kështu që, kushdo që e bën Mevludin me veprat e tij të mira dhe shmang të kundërtat e tyre, ka bërë një risi të mirë. Përndryshe, jo.

Në bazë të studimeve që kam bërë në këtë lëmi, arrita që këtë veprimtarë ta argumentoj mbi baza të qëndrueshme. Imam Buhariu dhe Muslimi në koleksionet e tyre kanë transmetuar se Profeti Muhamed (a.s.) kur pati emigruar nga Meka në Medinë, atje kishte parë se hebrenjtë e Medinës agjëronin ditën e Ashures (dita e dhjetë e muajit Muharrem). Kur Profeti (a.s.) i kishte pyetur për arsyen e agjërit, ata ishin përgjigjur: "Këtë ditë e agjërojmë, sepse kjo ditë është ditë e mirë, këtë ditë Zoti e ka shpëtuar Musain (a.s.) dhe e ka mbytur Faraonin. Ndaj për këtë, ne agjërojmë në shenjë falënderimi ndaj Zotit."

Nga hadithi kuptohet qartë legjitimiteti i agjërit në shenjë falënderimi ndaj Allahut të Madhërishtëm, për një mirësi ose për shpëtimin nga një e keqe. Ritual ky që kryhet çdo vit në të njëjtën ditë.

Mënyra e falënderimit ndaj Allahut (xh.sh.) konsiston në adhurimin ndaj Tij me mënyrat e ligjëruara si: sexhdja, agjërimi, sadakaja, leximi i Kuranit etj. A ka mirësi më të madhe në ditën e lindjes së Profetit Muhamed (a.s.), Profetit të Mëshirës, sesa vetë ardhja në jetë e tij?

Bazuar në këtë: Njeriu që e bën nijet, duhet të specifikojë ditën e saktë, në mënyrë që të përputhet me historinë e Musait (a.s.) në ditën e Ashures, dhe kushdo që nuk kujdeset për datën e saktë, nuk do ta ketë kujdes as muajin, por do të mjaftohet duke e kremtuar në një ditë çfarëdo gjatë vitit.

Kjo sa ka të bëjë me origjinën e Mevludit.

Sa i përket veprave që bëhen gjatë Mevludit, ato duhet të kufizohen në ato gjëra nëpërmjet të cilave vetëkuptohet mirënjohja ndaj Allahut të Plotfuqishëm, siç përmendëm më lart, leximin e Kuranit, sadakanë apo qerasjen e pjesëmarrësve me ushqim, si dhe recitimi i disa poezive lëvduese për Profetin (a.s.) që mund t'i nxisin zemrat për të bërë mirë dhe për të punuar për Ahiretin.

Sa i përket veprimeve të tjera që kryhen nëpër mevlude, si performanca argëtuese, ilahi etj., duhet thënë: Nuk ka asgjë të keqe në veprime, nëpërmjet të cilave kërkohet të shtohet kënaqësia e gëzimi atë ditë, me kusht që këto veprime të jenë të lejuara fetarisht (hallall). Ndërsa, nëse bëhet fjalë për veprime mekruh (të papëlqyera) e haram (të ndaluara), atëherë normalisht këto gjëra janë të ndaluara."

NJERIU QË NUK E NDRYSHOI DOT BOTA

Ebu Ubejde bin Xherrah (r.a)

Ebu Ubejde ishte një njeri që gjithmonë dhuroi siguri dhe e jetoi jetën si një amanet nga Zoti, madje, fitoi edhe zemrat e shumë të krishterëve.

Shokët e Profetit (salallahu alejhi ue selem) janë si yjet në qiell. Cilitdo prej këtyre yjeve që t'u përmbahemi është e sigurt se do të na çojë në Xhenet. Ky është lajm i përgëzuar nga vetë i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem).

Mendohet të ketë miliarda yje në qiell. Por secili yll është i ndryshëm në madhësi dhe shkëlqim. Edhe numri i këtyre yjeve (sahabëve), të cilët kishin nderin të gjenin një vend rreth Profetit (salallahu alejhi ue selem), shkruhet se është me dhjetëra mijëra, madje edhe në shifra afër njëqind mijë. Sigurisht, madhësia dhe shkëlqimi i gjithë këtij brezi të bekuar nuk është i njëjtë, ashtu si yjet në qiell. Disa prej tyre janë shumë shkallë më lart se të tjerët në aspektin e marrëdhënieve farefisnore që krijuan me Profetin (salallahu alejhi ue selem) ose detyrat administrative dhe ushtarake që morën përsipër gjatë momenteve më të vështira të Profetit (salallahu alejhi ue selem).

Një nga këta yjet më të ndritshëm për të cilët do të shkruajmë më poshtë, është Ebu Ubejde Ibn Xherrah. Duhet të jemi të vetëdijshëm se, secili prej nesh ka mësim shumë të rëndësishme për të nxjerr nga ky yll, i cili shkëlqen me aftësitë e tij dhe jetën e tij të pakompromistë në Islam.

Jeta e Ebu Ubejde bin Xherrah (radijallahu anh)

Ai lindi në Mekë 40 vjet para Migrimit (583). Dihet se Ebu Ubejde (radijallahu anh) ishte një nga myslimanët e parë. Në burimet tona, thuhet se ai u konvertua në Islam me ftesë të Ebu Bekrit (radijallahu anh). Ai emigroi në Abisini; por u kthye shpejt. Sipas asaj që përshkruhet në Tabakatin e Ibn Sa'dit: Ndërsa myslimanët e parë si Ebu Bekri (radijallahu anh) dhe Osmani (radijallahu anh) po predikonin Islamin fshehurazi; Omeri (radijallahu anh), Hamzai (radijallahu anh) dhe Ebu Ubejda (radijallahu anh) po e bënë këtë ftesë haptazi. Ai emigroi në Medine dhe mori pjesë në të gjitha betejat sa ishte gjallë Profeti.

Me urdhër të Profetit (salallahu alejhi ue selem), ai u caktua në Najran për të zgjidhur mosmarrëveshjet ligjore për shkak të një kërkesë të bërë nga njerëzit e Najranit.

Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: "Çdo komb ka një të besuar. Ebu Ubejde është udhëheqësi i këtij umeti".

Në ditën e vdekjes së Profetit (salallahu alejhi ue selem), emri i tij u përmend në mesin e kandidatëve për kalif gjatë debateve zgjedhore të kalifit në Sakîfetu Ben-i Saide. Ai u propozua për kalif nga Ebu Bekri (radijallahu anh) dhe Omeri (radijallahu anh). Megjithatë, ai nuk e pranoi. Ai ishte një nga të parët që i premtoi besnikëri Ebu Bekrit (radijallahu anh), duke thënë se personi më i denjë për kalifatin ishte Ebu Bekri. Ai mbajti detyra të rëndësishme ushtarake gjatë sundimit të kalifit të parë, Ebu Bekrit (radijallahu anh). U emërua një nga katër komandantët e caktuar për të pushtuar Gadishullin Arabik verior.

Ai vazhdoi si komandant i ushtrisë gjatë kohës së Omerit dhe ishte komandanti i përgjithshëm i ushtrive Islame. Ai vdiq në moshën 58 vjeçare në Damask për shkak të murtajës së Amvasit në 18/639.

Personaliteti i Ebu Ubejdes (radijallahu anh)

Ebu Ubejde (radijallahu anh) ishte nga e njëjta prejardhje si Profeti (salallahu alejhi ue selem). Me fjalë të tjera, ai ishte një i afërm i Profetit (salallahu alejhi ue selem) disa breza larg dhe ishte 12 vjet më i vogël se ai.

Ebu Ubejde (radijallahu anh) dhe babai i tij Abdullah bin Xherrah ishin të njohur për heroizmin dhe pasurinë e tyre. Abdullahu e donte shumë djalë të tij, Ebu Ubejden (radijallahu anh). Ai po bënte çmos për ta rritur atë mirë. Kështu, ai ishte një nga të paktët njerëz që dinte të lexonte dhe të shkruante në Mekë në atë kohë. Ky ishte një privilegj shumë i madh, duke marrë parasysh kushtet e asaj kohe. Fakti që Ebu Ubejde (radijallahu anh) dinte të lexonte dhe të shkruante, do të thoshte se ai ishte në një pozitë të respektuar në shoqëri. Ai kishte një oratori shumë të mirë dhe mjaft efektiv.

Ebu Ubejde bin Xherrah (radijallahu anh) ishte i famshëm

edhe për moralin e tij të mirë dhe praktikimin e përsosur të Islamit. Ai ishte një njeri shembullor. Jeta e tij e bukur nuk i shpëtoi vëmendjes së Profetit (salallahu alejhi ue selem).

Pasi Ebu Bekri (radijallahu anh) u bë kalif, ai duhej të merrej me kryengritjet e njerëzve që braktisën Islamin. Disa fise, ku Islami ende nuk kishte hyrë plotësisht në zemrat e tyre, u ngritën kundër qeverisë, pas vdekjes së Profetit (salallahu alejhi ue selem). Ata refuzuan të japin zekatin. Këto kryengritje në historinë Islame quhen "Ngjarjet Ridda" dhe e dëmtuan shumë unitetin e Islamit. Sidoqoftë, kalifi Ebu Bekër doli me vendosmëri kundër këtyre grupeve. Kështu edhe shkatërrimi i profetëve të rremë mori fund.

Meqenëse Jeruzalemi konsiderohet i shenjtë nga anëtarët e të tre feve hyjnore, si komandant i suksesshëm, Ebu Ubejde (radijallahu anh) donte ta mernte atë pa luftë, dhe i shkroi letrën e mëposhtme popullit të Jeruzalemit: "Bismillahirrahmanirrahim. Nga Ebu Ubejde bin Xherrah të patriarku i Jeruzalemit dhe njerëzit e tij! Paqja qoftë mbi ata që ndjekin besimin dhe udhëzimin e Allahut. Unë dua që ju të dëshmoni se nuk ka krijues përveç Allahut, se Ai është i vetëm, se Profeti Muhamed është shërbëtori dhe i dërguari i Tij, se gjithçka nga Allahu është e vërtetë, se parajsa dhe ferri janë të vërteta, se ju do të ringjalleni në ditën e gjykimit ... Nëse i pranoni, prona juaj do të na ndalohet, ju do të bëheni vëllezërit tanë në fe dhe do të ndani reputacionin tonë. Nëse nuk e pranoni këtë, unë do të marshoj kundër jush me një komunitet që e do vdekjen dhe do t'ju luftoj derisa t'ju kap dhe të ndaj pronën tuaj. Pranoni njërin nga këto dy ofertat!"

Megjithatë, si fillim, populli i Jeruzalemit jo vetëm që nuk iu bind, por as nuk e ndjenë nevojën për t'iu përgjigjur letrës së tij. Pasi ushtria marshoi dhe ata e kuptuan që nuk mund të përballeshin, përcollën një letër se ishin të gatshëm të dorëzoheshin, vetëm se çelësin e qytetit mund t'ia dorëzonin vetëm kalifit. Qyteti i Jeruzalemit ka një vend të rëndësishëm për tre fetë hyjnore. Meqenëse njerëzit e qytetit e dinin këtë, ata donin t'ia dorëzonin qytetin vetëm autoritetit më të lartë, përkatësisht kalifit.

Hazreti Ebu Ubejde (radijallahu anh) e ndaloi luftën me ardhjen e letrës. Ai ia bëri të ditur kalifit kërkesat e njerëzve të Jeruzalemit në një letër dhe e ftoi atë të marrë qytetin e Jeruzalemit. Kur letra arriti te Omeri (radijallahu anh); në konsultim me sahabët dhe duke e lënë Hazreti Aliun (radijallahu anh) si zëvendës të tij, Omeri u nis për në Jeruzalem. Ai u takua me ushtrinë e tij dhe më pas u takua me delegacionin nga Jeruzalemi. Të nesërmen, ai hyri në qytet, duke marrë Ebu Ubejden (radijallahu anh) me vete dhe ushtrinë islame pas tij.

Ebu Ubejde (radijallahu anh) jetoi një jetë që i shkonte për shtat shokëve të Profetit (alejhi selam). Një ditë kur Omeri (radijallahu anh) bëri një vizitë në Damask gjatë kalifatit të tij, u mirëprit nga komandantët e ushtrive. Mirëpo, Hazreti Omeri (radijallahu anh) nuk mund të rrinte pa vizituar mikun e tij të dashur Ebu Ubejden (radijallahu anh). Pasi u takuan dhe u përqaftuan, Ebu Ubejde (radijallahu anh) e ftoi kalifin në çadrën e tij. Kur Omeri (radijallahu anh) mbërriti në çadrën e tij, ai nuk mundi t'i përmbante lotët kundrejt asaj që pa. Pasi në çadrën e komandantit të madh Ebu Ubejde (radijallahu anh), nuk mund të shihte gjë tjetër veçse një shpatë, një

mburojë, një shtizë, një tas me ujë, një pjatë për ushqim dhe një ibrëk për ujë: Omeri (radijallahu anh) nuk duroi dot dhe e pyeti: "Miku im i dashur! A nuk ke fituar gjë gjatë kësaj kohe, a nuk ke diçka, të paktën sa shokët e tjerë?"

Ai ja ktheu: "O Prijësi i besimtarëve! Këto janë mëse të mjaftueshme për ne."

Omeri (radijallahu anh) shpërtheu në lot dhe tha këto fjalë me vështirësi: "O Ebu Ubejde! Bota na ka ndryshuar të gjithëve nga pak. Por unë shoh se ajo nuk të paska ndryshuar ty aspak!"

Po, bota i kishte kapur dhe ndryshuar të gjithë nga pak, por kurrësi nuk mundi të ndryshojë atë! Ebu Ubejde bin Xherrah (radijallahu anh) ishte një nga ata njerëz të rrallë, të cilëve bota nuk mundi t'i tërhiqte në grackën e saj. Edhe pse ishte komandant i përgjithshëm, ai mbante të njëjtat rroba si ushtarët nën komandën e tij. Ai kurrë nuk dilte para ushtarëve të tij me rroba të ndryshme. Çfarëdo që ata hanin dhe pinin, ai hëngri dhe piu të njëjtat gjëra bashkë me ata.

Në rajonin e Damaskut, kishte filluar epidemia e madhe e murtajës së Amvasit. Murtaja dukej se do të vazhdonte të përhapej. Kur Omeri (radijallahu anh) e kuptoi seriozitetin e epidemisë edhe pse ishte kthyer në Medinë me shoqëruesit e tij, përsëri mendjen e kishte akoma te shoku i tij i dashur, Ebu Ubejde (radijallahu anh) dhe i duhej të bënte gjithçka që mundej për ta larguar atë që andej para se të sëmurej. Kështu që i shkroi një letër ku thuhej: "Paqja qoftë mbi ty, o Ebu Ubejde! Kam shumë nevojë për ty tani. Unë do të doja të diskutoja dhe të konsultohesha me ty për një çështje të rëndësishme. Sapo të marrësh letrën time, nis menjëherë!"

Ebu Ubejde (radijallahu anh) e kuptoi qëllimin e kalifit. Ishte e qartë se ai donte ta largonte nga zona e rrezikut në një vend të sigurt. Megjithatë, Ebu Ubejde (radijallahu anh) nuk mund të linte ushtarët e tij dhe të largohej prej andej. Ai i shkroi një përgjigje kalifit ku thuhej: "Paqja qoftë mbi ty, o Kalif i besimtarëve! Unë e di pse më kërkon. Unë jam komandanti i ushtrive islame. Unë nuk mund t'i braktis ato dhe të mendoj për veten mbi to. Caktimi i Zotit nuk ndryshon. Nëse vdekja ime është e caktuar, unë do të vdes kudo që të ndodhem. Unë nuk mund të largohem nga shokët dhe të shkoj i vetëm në një vend të sigurt. Kur letra ime të arrijë tek ju, të ma bëni hallall dhe të më lini të qëndroj këtu."

Para murtajës së Amvasit, numri i ushtarëve të Ebu Ubejdes (radijallahu anh) ishte rreth 36 mijë. Murtaja po përhapej aq shpejt sa brenda pak javësh, numri i ushtarëve kishte rënë në 6,000. Mijëra ushtarë, përfshirë edhe komandantin Ebu Ubejde (radijallahu anh) humbën jetën në epidemi. Kur Ebu Ubejde (radijallahu anh) u sëmur dhe po priste vdekjen, Muadh bin Xhebel (radijallahu anh) filloi të drejtonte faljen e namazit në vend të tij. Ditën e vdekjes së tij, Muadhi (radijallahu anh) u ngjiti në minber dhe tha:

"O njerëz! Dijeni që keni humbur një njeri të madh. Unë nuk mendoj se keni parë ndonjëherë një njeri të tillë si komandanti juaj Ebu Ubejde në mesin e robërve të Allahut. Ai ishte shumë i pastër në zemër. Nuk do të mbante mëri. Kurrë nuk ushqeu keqdashje ndaj askujt në zemrën e tij. Ai ishte një monument i modestisë dhe moralit. Ai gjithmonë u jepte këshilla të bukura njerëzve. Allahu e mëshiroftë. Amin!"

Durimi ËSHTË DRITË

Këtë shkrim ua dedikojmë zemrave të thyera, secilit prej jush që në familjet tuaja keni një të sëmurë, secilit të varfër që lufton për kafshatën e gojës, secilit që gjendet në brenga të mëdha, secilit që ka ra në fatkeqësi, secilit shpirt të tendosur, i cili nuk ndihet i qetë në këtë botë. Gjithashtu, këtë temë ia adresojmë edhe atyre që jetojnë në pasuri, pa brenga dhe në begati. Pra, atyre të cilët asnjëherë nuk mendojnë se ndoshta, mos e dhashtë Zoti, mund të bëhen nga kategoria e parë.

Durimi është dritë e besimtarit, që e udhëheq në errësirat e sprovave, brengave dhe fatkeqësive të ndryshme me të cilat ballafaqohen gjatë jetës. Durimi është garanci me të cilën garantohet suksesi njerëzor, pa të cilin nuk mund të arrihet asgjë.

Allahu i Madhërishëm e ka përmendur 90 herë termin durim në Kur'an. Sot, desha që bashkërisht të përkujtojmë një rob të madh të Allahut, një profet të ndershëm e të respektuar, Ejubin a.s.

Allahu xh.sh. i kishte dhuruar Ejubit a.s. disa begati të mëdha:

1. I kishte dhënë pasuri dhe patundshmëri aq të madhe, sa që vlera e asaj pasurie nuk mund të matej.

2. I kishte dhënë me qindra robë (shërbëtorë) që ishin në shërbimin e tij.

3. I kishte dhënë një bashkëshorte besimtare dhe shumë të bukur.

4. I kishte dhënë trup të bukur e të fuqishëm.

5. I kishte dhënë 14 fëmijë.

6. I kishte dhënë një popull, i cili e dëgjonte atë dhe i praktikonte këshillat e tij.

7. I kishte dhënë miq, me të cilët shoqërohej vazhdimisht, gjë që do ta dëshironte secili prej nesh.

8. Bashkëvendësit e donin shumë dhe kishin një respekt të veçantë për të, e shumë begati të tjera.

Shikoni vëllezër, Ejubi a.s., ishte në një gjendje materiale, shoqërore dhe psikike në një nivel të lartë, për t'ia pasur lakminë ç'do kush. Kështu jetoi plot 50 vite, pa asnjë brengë. Pas kësaj lumturie dhe begatie, Allahu xh.sh. deshi ta sprovonte me një sprovë të madhe. Andaj, në shembullin e Ejubit a.s. mund të gjejmë ngushëllim ata që janë në fatkeqësi dhe mund

të marrin mësim ata që janë në begati.

Sprova e parë ishte që Allahu ia mori tërë pasurinë dhe Ejubi a.s. mbeti i varfër. Të gjitha të hollat që i kishte futur në tregti dhe bujqësi i humbën.

Sprova e dytë: I vdiqën të gjithë fëmijët.

Sprova e tretë: Të gjithë robërit u detyrua t'i shesë dhe në fund mbeti pa asnjë shërbëtor.

Sprova e katërt që Allahu e sprovoi, ishte sëmundja që e bëri të zërë shtratin. Miqtë e braktisën duke u frikësuar nga sëmundja që e kishte goditur. Të gjithë e braktisën, përveç bashkëshortes dhe dy shokëve të ngushtë. Tërë dynjaja e la! Ndërsa ne sot, nga sprova më e vogël fillojmë të pyesim. Çfarë kam bërë? Pse unë, që nuk ia dua të keqen askujt? etj.

Allahu në Kur'anin fisnik thotë: "E njeriu, kur e sprovon Zoti i tij, e nderon dhe e begaton, ai thotë: "Zoti im më ka nderuar!" dhe pastaj vijon verseti: "Por, kur për ta sprovuar ia pakëson furnizimin (e varfëron) ai thotë: "Zoti im më ka nënçmuar" "Jo, nuk është ashtu! (punoni edhe më zi) ju nuk e përfillni bonjakun" (El-Fexhr, 15-17).

Ejubi a.s., profet i dashur i Allahut, i humbi të gjitha dhe mbeti pa asgjë, pa fëmijët e dashur, pa shokë e miq; të gjithë e braktisën. Ky është mësim për gjithë ata që nuk e njohin mossuksesin. Jetoni në tokë, mos lejoni që dynjaja t'ju verbojë dhe të harroni se jeni robë të Zotit që jeni të varur nga mëshira e Tij.

Ke shumë para, ke ndikim në shoqëri, ke funksion dhe pozitë, të gjitha i ke Por, mos lejo që të gjitha këto të të largojnë nga Allahu xh.sh., mos lejoni që të gjitha këto t'ju shmangin nga principet fetare dhe njerëzore.

Kujtoni kur Ejubi a.s. mbeti i varfër dhe i palëvizshëm, bashkëshortja e tij u bë shërbëtoreshë për ta ushqyer burrin e saj. Kjo situatë e vështirë zgjati plot 18 vite. Për këtë, vëllezër të dashur, nëse ballafaqoheni me problemet e jetës bëni durim, sepse sprovat tona janë të vogla në krahasim me udhëheqësin e durimtarëve, Ejubin a.s.

Kur neve dikush na ankohet për ndonjë problem, ne i themi: "Bëj sabër! Shpesh herë dëgjojmë "Deri kur? Nuk mundem më ...!

Profeti s.a.v.s. ka thënë: "Durimi është dritë".

Secila vepër dhe për secilën lëvizje duhet durim. Për t'u larguar nga harami nevojitet durim, për bërjen e veprave të mira duhet pasur durim, për kryerjen e namazit, agjërimit, për dëgjimin e hutbes nevojitet durim ... jeta jonë në realitet është durim!

Një dijetar ka thënë: A mendon se mund të arrish diçka të vlefshme pa durim?! Secila reformë vjen me durim, secili sukses vjen me durim, secila lumturi vjen me durim. Në të kundërtën, asgjë e keqe nuk na ndodhë, e të mos jetë shkas i mosdurimit. Dikush vjedh, sepse dëshiron të pasurohet shpejt pa pasur durim, dikush bën zina, sepse nuk ka durim derisa të martohet, dikush blen diplomën, sepse nuk ka durim të mësojë, dikush konsumon drogën, sepse nuk mund të ballafaqohet me peripecitë e dynjasë ...

Pra, vëllezër, durimi është aq i rëndësishëm saqë Allahu xh.sh. na e bëri shembull jetën e një profeti të

dashur, model të gjallë për të na mësuar që të bëhemi të durueshëm!

Sa herë që Allahu xh.sh. në Kur'an përmend durimin, me të vjen fjala ose i tërë verseti, që paralajmëron fitoren dhe tejkalimin e sprovës si p.sh.: "Ne do t'ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta edhe nga frytet, por ti jepu myzhde durimtarëve" (El- Bekare, 155). ose "Vërtetë të durueshmëve do t'ju japim shpërblim pa llogari" Kjo është rruga e suksesit, kjo është rruga e lumturisë. (Të mendojmë për këtë verset dhe ta praktikojmë në jetën tonë).

Profeti a.s. ka thënë: "Dije se fitorja vjen me durim!" Mos të harrojmë se njëri prej emrave të bukur të Zoti është es-Sabur - Durimtari, dhe mjafton që ne të pajisemi me bukurinë e këtij emri. Profeti a.s. ka thënë: "Njeriu nuk i është dhënë dhuratë më e madhe se durimi".

Kthehemi te Ejubi a.s. Bashkëshortja e tij e ndershme ishte aq e lodhur nga puna, nënçmimi, sa që një ditë Ejubit a.s. i tha: "A nuk je i dërguar i Allahut?" "Natyrisht që jam" ia ktheu ai. "Atëherë përse nuk e lut Allahun të na lehtësojë vuajtjet tona?" Ejubi e pyeti: "Sa vite kemi jetuar në begati dhe rehati?" "50 vite" tha ajo. "Për sa kohë jemi në vështirësi?" "18 vite" u përgjigj ajo. Atëherë Ejubi a.s. tha: "Allahu 50 vite më ka mbuluar me begati, a mos të kemi durim 18 vite? Pasha Allahun nuk do t'i lutem derisa të bëhen 50 vite durim".

Një herë gruaja i solli një gjellë të shijshme. Kur e pa Ejubi a.s., e pyeti: "Po kjo?" "Shita gërshetin tim për bërë këtë gjellë për ty" tha ajo. Ky gjest i bashkëshortes e preku thellë Ejubin a.s., nuk mund t'ia bëjë hallall vetes për vuajtjet e gruas së tij. Vetëm atëherë vendosi t'i drejtohet Allahut xh.sh. për mëshirë dhe ndihmë. Dëgjoni lutjen e Ejubit a.s. të cilën na sjell si shembull Allahu i Madhërishëm në Kur'anin fisnik: "(Përkujto) Edhe Ejubin kur iu drejtua Zotit të vet me lutje: "Më gjeti belaja, e Ti je më mëshiruesi ndër mëshiruesit." (El-Enbija, 83). Pra, nuk u ankua, nuk përmendi detajet e vështirësisë së tij. Më tej vazhdon: "Përkujto edhe robin tonë Ejubin kur me lutje iu drejtua Zotit të vet: "Djali më ka goditur me mundime dhe vuajtje." (Sad, 41) Dhe Allahu iu përgjigj lutjes së tij: "Bjeri me këmbën tënde tokës! Ky është (ujë) i ftohtë, për larje dhe pije." (Sad, 42) "E nga mëshira jonë dhe mësim për ata që kanë të menduar, Ne ia falëm familjen e tij dhe po aq sa ishin ata." (Sad, 43)

Pas kësaj, Allahu xh.sh. ia kompensoi të gjitha. Si një përfundim madhështor në tregimin e Ejubit a.s. janë fjalët e Allahut xh.sh.: "Vërtet, Ne e gjetëm atë të durueshëm. Sa shumë rob i mirë ishte ai dhe i kthyer te Zoti." (Sad, 44)

A keni dëgjuar ndonjëherë lavdërim më të bukur, më përmbledhës, më përmbajtës, më emocionues se ky lavdërim i Allahut ndaj robit të Tij të sinqertë e durimtarë, Ejubit a.s.?

I lutemi Allahut të na nderojë me durim, i cili do të jetë dritë e lumturisë dhe suksesit në dy jetët, dhe të jemi prej robërve të sinqertë të Allahut, që pendohen shumë dhe janë durimtarë.....Amin.



HOXHË KADRI PRISHTINA (1946-2021)

**MINISTRI I DREJTËSISË QË U AKUZUA
PËR RIVENDOSJEN E SHERIATIT
NË DREJTËSINË SHQIPTARE**

"Kërkimi i s'vërtetës është e drejt e mendjes"

Për këtë figurë të shquar të historisë së kombit shqiptar është shkruar shumë, janë botuar 2-3 monografi, është përmendur në faqet e Historisë së Popullit Shqiptar, në fjalorë të shumtë, në shumë kumtesa e trajtesa shkencore, që nga periudha e sistemit komunist, të cilët këtë figurë e ngritën lart, pasi kishte qenë kundërshtari politik i Ahmet Zogut, dhe sistemit i interesonte, aq sa pothuajse nuk e quajtën 'komunist' me bindje dhe ideale, po ashtu dhe në dy dekadat post-komuniste.

Por cili është realiteti mbi këtë figurë kaq të shquar e të njohur? A ka vërtetë akoma për të zbuluar mbi historinë e tij edhe pse është shkruar kaq shumë për të deri më tani!? Cilat ishin bindjet e tij që e drejtuan në një veprimtari aq të madhe sakrifikuese ndaj vetes dhe familjes në të mirë të kombit?

Realiteti është se: "Në të gjithë shkrimet që janë shkruar për të¹ qëllimisht është lënë pa hulumtuar një segment tejet i rëndësishëm i veprimtarisë së Hoxhë Kadriut, që është aspekti islam i jetës dhe i veprës së këtij dijetari të madh»² Për më tepër, aq shumë është abuzuar në këtë drejtim, veçanërisht nga historia komuniste, sa Jup Kastrati, në kumtesën e tij mbi historinë e Hoxhë Kadriut në vitin 1965, thotë se: **"Hoxhë Kadriu vërtetë studioi për fe, por nuk qe fanatik. Ceremonitë fetare për të nuk kishin rëndësi. Urronte ndasitë fetare dhe punoi për bashkimin e popullit."**³ Ndërsa krejt të kundërtën na tregojnë veprat e tij reale, veçanërisht në botimin e tij "Udha e s'vërtetës" në vitin 1923, në të cilën hollësisht trajton çështjet fetare si: Nevoja e fesë, Feminizma-Martesa me Kunorë (në pikpamjen fetare), Burimi i mendimit të besimit në njerëzi, Besimi i Natyrës, dhe të tjera, me një analizë të hollë dhe të thellë si një hoxhë i vërtetë ashtu si ishte. Aty ai trajtonte edhe tema të tjera politiko-ekonomike e sociale, gjithmonë nga këndvështrimi i formimit të tij, si fetar me njohuri të thella, duke analizuar aktualitetin politik e social të vendit në fillimin e viteve '20 të shek. XX, apo përse myslimanët janë në gjendje të mjerueshme në Shqipëri, por dhe në mbarë botën, duke fajësuar drejtpërdrejt popullin për injorancën dhe veçanërisht lëshimin e Fesë së Allahut për gjendjen e mjerueshme të myslimanëve. Hoxhë Kadriu thotë se: **"Myslimanët për shkak të padijes që i ka mbulue tash 8 shekuj, e prej pa-kujdesimit për fe dhe tuej u larguë prej dispozitave fetare kanë mbetë mbrapa dhe tuej mos mbajtë qytetërimin që kishin fituar para 8 shekujve kanë mbetë në gjendjen e mjerueshme që gjenden sot."**⁴ Pra, duket qartë në të vërtetë se a ka

qenë fetar Hoxhë Kadriu apo jo!

Hoxhë Kadriu ishte një nga 9 fëmijët e Lutfullah Halimit (me origjinë të largët nga Shkodra),⁵ lindi në Prishtinë në vitin 1878, po aty kreu mësimet fillestare të shkollës, ndërsa të mesmen e përfundoi në Shkup në shkollën e njohur të asaj kohe "Dar-ul-Mualim". Studimet e larta i vazhdoi në Stamboll, u regjistrua në Shkollën e Lartë Pedagogjike "Dar-ut-Tedris", të cilën e përfundoi me sukses, por nuk u kënaq me vetëm dy vite, prandaj dhe u regjistrua e mbaroi me sukses "Medresenë Fatih", shkollë fetare islame dhe e famshme në Stamboll.⁶ Në 1903-1904 në moshën 25-vjeçare, ai i nënshtrohet provimeve për të marrë titullin shkencor "Profesor Publik në Stamboll", nga Shkolla e Lartë e Drejtësisë, në të cilën diplomohet me rezultate të shkëlqyera, direkt pas kësaj u fut në punë pranë Gjykatës së Apelit të Këshillit të Shtetit në Stamboll.⁷

Disa nga ngjarjet më të rëndësishme të jetës së tij derisa u konsolidua në Shqipëri

Në vitin 1905 ai u burgos deri në vitin 1908, kur u shpall kushtetuta e re dhe u lirua nga internimi. Në vitin 1911 caktohet këshilltar ligjor i Drejtorisë së Përgjithshme i Bankës Osmane në Stamboll, në gusht të vitit 1914 ai kthehet në Shqipëri, prej së cilës nuk do të largohet më, dhe pikërisht në atdhe do të jetë kontributi më i madh i tij.⁸

Jeta e tij në Stamboll nuk do të ishte aq e lehtë dhe e thjeshtë, sa lexohet në këta rreshta, por pikërisht kalvari i vështirësive dhe i vuajtjeve e bënë Kadriun më të ndërgjegjshëm dhe me një formim fetar, intelektual dhe njerëzor për t'u çmuar, dhe pikërisht përgatitja e puna e tij i dhanë titullin "Hoxhë" të mirënjohur në shoqërinë osmane, që ka kuptimin e "mësuesit" apo të "profesorit" në aspektin fetar, por jo vetëm.

Gjatë Luftës së Parë Botërore ai punoi si avokat në Shkodër, qyteti ku vendosi për të jetuar, menjëherë sapo erdhi në Shqipëri. Gjithashtu, ai u angazhua me patriotë të tjerë për ruajtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë, dhe me bashkimin e trojeve shqiptare, ishte lideri shpirtëror dhe drejtues organizativ i Lëvizjes për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, si dhe trojeve të tjera nga copëtimi. Aktiviteti i tij do të vazhdonte intensivisht nga viti 1918 deri në ndarjen nga kjo botë.

Me 1 maj 1918 me iniciativën e Hoxhë Kadriut dhe patriotëve të tjerë, u themelua "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" me qendër në Shkodër dhe degë në

Kombëtare Tiranë, gjithashtu dhe librin e Q. Morinës, i cili e ka analizuar hollësisht revistën.

5. Eqber Skëndi, Hoxhë Kadriu, Rilindja Prishtinë 1992, f. 10

6. 100 personalitete shqiptare të kulturës Islame, K.M.SH., Tiranë 2012, f. 127-129.

7. A.Q.Sh. F. 822, D. 1, f. 708-581, cituar nga Eqber Skëndi.....f. 14

8. Për më shumë shih Pal Doçin... dhe Eqber Skëndin...

1. Përfshijë vetëm Qemajl Morinën, apo ndonjë shkrim të viteve të fundit, që ka një qëndrim disi më ndryshe.

2. Qemajl Morina, Hoxhë Kadriu Prishtina-mendimtari islam, M.D.I. Prishtinë 2000, f. 18.

3. Jup Kastrati, Hoxhë Kadriu, ILPSH, nr. 3 Shkodër 1965, f. 440.

4. Udha e s'vërtetës; Nr. 1, shtator 1923, Shkodër. Për më shumë mbi këtë çështje shih revistën e plotë që gjendet në Bibliotekën

shumë qytete të tjera shqiptare, Komitet që deri në përfundim të jetës së komitetit (1928), ishte aktiv në mbarë Shqipërinë për mbrojtjen, qoftë dhe me forcë të trojeve shqiptare të Kosovës, ndërsa Hoxhë Kadriu ishte drejtues i komitetit deri në vdekjen e tij. Që në fillim të veprimtarisë ai këshillonte drejtuesit lokalë që në fillimet e "M.K.K-së" që: "...të këshillonin popullin të bëhet gati me i dalë zot pavarësisë e tanësisë tokësore të Shqipërisë"⁹. Komiteti shtroi si detyrë të përpqej për çlirimin kombëtar të vendit, për rimëkëmbjen e shtetit të pavarur shqiptar dhe për bashkimin e Kosovës me shtetin shqiptar.¹⁰ Ky komitet u mundua ta kryejë detyrën e vet patriotike deri në fund, edhe pse vendimet për "Shqipërinë e copëtuar" ishin marrë të pakthyeshme që në Konferencën e Londrës (1913), gjithashtu u ritheksuan sërish në Konferencën e Paqes në Paris, aktiviteti i Komitetit shkoi deri aty sa t'i drejtohet Lidhjes së Kombeve me një notë proteste në vitin 1924, duke vënë në dijeni Lidhjen për masakrën serbo-malazeze ndaj popullsisë shqiptare. Në të thuhej: "...Ky regjim hekuri, zjarri e grabitjeje përbën shkakun kryesor të një emigrimi në masë të popullsisë drejtë Turqisë, emigrim ky që bëhet në kushte të tmerrshme dhe që kushton jetën e qindra familjeve, dhe, pjesa tjetër që mbeten dënohen me një mjerim të pashërueshëm mjafton me ditë se për mijëra krime të bëra në mes të ditës asnjë nuk është ndjekur nga gjyqet (nuk është gjykuar).... Është vendi i vetëm në botë ku mund të vriten qytetarët në prani të gjyqtarëve që heshtin."¹¹

Mbas Luftës së Parë Botërore dhe aktiviteteve që po zhvilloheshin në Konferencën e Paqes në Paris, shqiptarët e panë një detyrim që të përfaqësoheshin me një përfaqësi të një Qeverie Kombëtare para konferencës, shtoi këtu dhe nevojën e menjëhershme që vetë Shqipëria kishte për një qeveri që të drejtonte vendin. Kështu që, Kadriu bashkë me patriotë të tjerë ndërmorën një "mbledhje-kuvend" mbarëkombëtar në Lushnjë, të quajtur Kongresi i Lushnjës, që do të rezultonte i dobishëm për vetë ekzistencën e Shtetit Shqiptar, dhe për fillimin e një jetë të re të një shteti të brishtë modern shqiptar.

Kongresi i Lushnjës i hapi punimet e tij më 21 Janar 1920 dhe vazhdoi për gjatë 10 ditëve nga ku u morën vendime mjaft të rëndësishme për Shqipërinë, ndër të cilat: 1. Mosnjohja e vendimeve të Konferencës së Parisit, duke i kundërshtuar dhe duke premtuar që trojet shqiptare do të mbrohen edhe me gjak nëse është e nevojshme. 2. Shpalljen e Shqipërisë Sovrane me organet drejtuese, duke filluar që nga Këshilli i Lartë, i përfaqësuar nga 4 anëtarë që do luanin rolin e kryetarit të shtetit, zgjodhi Këshillin Kombëtar (Parlamentin) prej 37 anëtarësh, që do të ishte i tillë

deri në zgjedhjet që do të zhvilloheshin, ku populli të vendoste vetë. 3. Shfuqizimi i Qeverisë së Durrësit dhe formimi i një qeverie tjetër, të dalë nga Kongresi me në krye Sulejman Delvinën, ku ky i fundit do të zgjidhte Hoxhë Kadriun si Ministër të Drejtësisë. Nga vendimet e Kongresit të Lushnjës ishte dhe vendosja e Tiranës si Kryeqytetin e vendit.¹²

Hoxhë Kadriu ishte njohës shumë i mirë i Jurisprudencës dhe kishte eksperiencë të gjatë në këtë fushë, por cilësitë e tij e bënë akoma më të veçantë si burrë shteti, ashtu si do të ishte vlerësimi i bashkëkohësve të tij për të, nga marrëdhëniet e punës që kishin patur në Komitetin e M.K.K-s, të cilët thonin se: Hoxha ishte i qartë në problemet që shtronte, shumë kërkuar në zbatimin e detyrave që kishte çdo anëtar i Komitetit. –por kjo ishte vetëm një pjesë e seriozitetit të këtij njeriu, më pas për të thuhet se: - Ai ishte me horizont shumë të gjerë, i afrueshëm dhe komunikues me njerëzit, qoftë dhe me njeriun më të thjeshtë, por ishte i vendosur dhe pa kompromis. Ishte njeri me autoritet dhe i respektueshëm nga të gjithë. Shtëpia e tij ishte derë e hapur që nuk mbyllej për miqtë e shokët.¹³ Ndërsa vetë Ministri i Drejtësisë i sapozgjedhur H. Kadriu shprehej se drejtësia mund të kryente rolin e saj vetëm duke u mbështetur mbi parimet: Qëndrim sa më të butë për vegjëlinë, e as një lëshim për krerët, asnjë marrëveshje me ta, ky duhet të jetë qëndrimi i parlamentit,¹⁴ kur parlamenti po hartonte ligjet mbi organizimin e Drejtësisë.

Sfidat e qeverisë së re ishin të shumta, por më kryesorja ishte shtrirja e "fuqisë" së saj në mbarë territorin shqiptar me kufij të përcaktuar nga ndërkombëtarët, pasi gjithandej ishte kaos. Meritë të padiskutueshme në sukseset e qeverisë, kishte pikërisht Hoxhë Kadriu, pasi më 11 mars 1920, mbas shumë vitesh nën drejtimin e ndërkombëtarëve apo e pushtuar, Shkodra më në fund do të qeverisej nga Qeveria Shqiptare e Lushnjës, ku Ministri i Drejtësisë Hoxhë Kadri Prishtina (i cili e njihte mirë qytetin, pasi aty ishte dhe veprimtaria e tij me anë të MKK) dhe Ministri i Punëve të Brendshme Ahmet Zogu u futën si triumfues duke marrë në dorë drejtimin e qytetit.¹⁵

Mbas Shkodrës, sfidat e tjera do të ishin Durrësi dhe Vlora, futja e këtyre dy qyteteve me rëndësi në administratën e qeverisë së re, e cila do të realizohej gjithashtu falë këmbënguljes, trimërisë dhe seriozitetit të H. Kadiut.

Qeveria e zgjedh sërish Hoxhën si përfaqësuesin e saj për bisedime me palën italiane të cilët jo vetëm Vlorën, por tashmë kishin shtënë në dorë edhe Durrësin duke përfutur nga gjendja në vend. Përfaqësuesi

12. Historia e Popullit Shqiptar V.3, Toena, Tiranë 2007, f. 139-150

13. Nivila Hoxha, 70 vjetori i themelimit të komitetit 'Mbrojtja Kombëtare e Kosovës' Shkodër 1988; kumtesa gjendet pranë Institutit të Historisë në Tiranë.

14. A.Q.Sh. F.838, D. 81, f. 232-234.

15. Historia e Popullit Shqiptar V.3, Toena, Tiranë 2007, f. 148

9. Pal Doçi, Hoxha Kadri Prishtina, f. 33, Geer 2005, Tiranë.

10. Historia e Popullit Shqiptar V.3, Toena, Tiranë 2007, f. 124.

11. Jup Kastrati, Hoxhë Kadriu, kumtesë me rastin e 40 vjetorit të vdekjes, Buletin ILPSH nr. 3, Shkodër 1965, f. 439.

italian ishte një njohësi i mirë i Shqipërisë dhe një diplomat karriere, të cilin e zgjodhën për t'i bindur shqiptarët t'ia lejonin Italisë "mbikëqyrjen" e Shqipërisë. Sipas burimeve arkivore, sukcesi i të votëbesuarve të Qeverisë Shqiptare, Hoxhë Kadriu dhe Ndoc Çoba, ishte i padiskutueshëm, sepse mbas shumë këmbënguljesh, ata arritën që t'i largojnë italianët nga Durrësi, të cilët ishin futur shpejt dhe papritur gjatë formimit të Qeverisë së Kongresit të Lushnjës.¹⁶ Përfaqësuesit e Qeverisë Shqiptare guxojnë duke i dhënë ultimatum italianëve që të largohen nga Durrësi deri në orën 10 të datës 18.05.1920, mbas kësaj misioni diplomatik quhet i kryer dhe nëse akoma nuk janë larguar nga Durrësi, qeveria do të detyrohej të vepronte në rrugë të tjera.¹⁷ Qeveria e Sulejman Delvinës do të jepte dorëheqje mbas 8 muajsh. Nga ministrat më të suksesshëm të saj, pa diskutim që ishte Hoxhë Kadri Prishtina, i cili më pas do të kishte funksione në parlament.

Në zgjedhjet e para parlamentare që u bënë në Shqipëri në vitin 1921, Hoxhë Kadriu u zgjodh Përfaqësues i Prefekturës së Dibrës (Deputet) gjatë kohës 21 prill 1921 – 30 shtator 1923.¹⁸ Gjithashtu, në vitin 1921 ai u zgjodh edhe nënkryetar i Parlamentit, si dhe anëtar i komisionit të drejtësisë.¹⁹ Më 1 gusht 1921 Këshilli Kombëtar (Parlamenti) caktoi një grup pune i përbërë nga 12 anëtarë, mes tyre edhe Hoxhë Kadri Prishtina²⁰, të cilët do të merreshin me zgjerimin e "Kushtetutës" e quajtur ndryshe Statusi i Lushnjës, i cili kishte vetëm 3 nene dhe ishte nevoja për zgjerimin e tij, gjë që u realizua duke e Zgjeruar Statusin e Lushnjës, i përbërë mbas këtij punimi nga 129 nene që rregullonin nga ana ligjore mbarëvajtjen e Shtetit Shqiptar.²¹

Më 6 dhjetor 1921 Këshilli i Lartë i drejtohet Qazim Kacullit për formimin e një qeverie, gjë të cilën ai e mori përsipër. Gjatë formimit të kabinetit, cakton Kadri Prishtinën si Ministër Drejtësie, por ngaqë një pjesë e mirë e kabinetit nuk pranuan postet, formimi i qeverisë dështoi, Këshilli i Lartë i drejtohet Hasan Prishtinës për formimin qeverisë, ky i fundit has vështirësi në formimin e saj, Hasani emëron Hoxhë Kadriun Ministër Drejtësie, si njeri të besuar të tijin, por dhe si jurist i zoti. Gjithashtu, e ngarkon edhe me detyrën e zv/Ministër i Punëve të Brendshme, pasi Luigj Gurakuqi i caktuar si Ministër ishte jashtë vendit, dhe kjo qeveri do të zgjaste vetëm 5 ditë, 7-12 dhjetor 1921.²²

16. AQSH, Fondi 846, D. 30, cituar nga Pal Doçi, në Hoxha Kadri Prishtina, f. 48, cituar më lart.

17. AQSH, Fondi 846, D. 31, cituar nga Pal Doçi, në Hoxha Kadri Prishtina, f. 48, cituar më lart.

18. Përgatiti: Diana Estrefi; *Ligjvënësit Shqiptarë 1920-2005; Kuvendi i Shqipërisë, Tiranë 2005.*

19. Eqber Skëndi, Hoxhë Kadriu, Rilindja Prishtinë 1992, f. 140

20. Arben Puto, Shqipëria Politike 1912-1939, f.319, Toena 2009 Tiranë.

21. Historia e Popullit Shqiptar V.3, Toena Tiranë 2007, f. 187, 182.

22. Kastriot Dervishi; Kryeministrat dhe ministrat e shtetit shqiptar në 100 vjet; 55 Tiranë 2012.

Gjatë karrierës së tij politike, për t'u theksuar është akuza që iu bë nga Savri Vinjau, kur nuk ishte më Ministër, se e kishte rrënuar Ministrinë e Drejtësisë në 3 aspekte: Organizim, financë dhe personel.

1. Se institucioni dhe organizimi i gjykatave është i çuditshëm, ose më saktë është Fetar-Islam, me njerëz të çuditshëm që nuk pranojnë negocime, kundërshtime, diskutime, që gjykojnë me Sheriat dhe mungon siguria, pasi me të gjykojnë vetëm hoxhallarët në gjuhën 'turke' (osmane), gjuha në të cilën ishte gjykuar gjatë Sundimit Osman, dhe kjo nuk ishte e pëlqyer për të.

2. Në harxhimin e shumë të hollave, për të ngritur këto institucione-gjykatat, me mbi 200.000 f.a. në total për mbarë Shqipërinë, dhe sipas S. Vinjaut nuk ishte e nevojshme.

3. Si dhe në personel, në numër të shumë që ka marrë, duke mos qenë e nevojshme. Theksin e kritikës S. Vinjau ndaj Ministrit të Drejtësisë (1920) më së shumti e vendos në kapacitetin njerëzor, pasi ai kishte urdhëruar që çdo gjykatë minimalisht të kishte 3 anëtarë, ndërkohë që personeli për këtë mungonte dhe për më tepër që duheshin njohës të sistemit "osman" ose thënë ndryshe të Sheriatit, dhe se kategorikisht duhej që mbarë Gjyqësori në vend të pastrohej njëherë e mirë prej "Gjykatave Fetare Islame", pasi për të ishte totalisht i papranueshëm gjykimi me Gjyqtarët e Sheriatit.²³

Në zgjedhjet e radhës të vitit 1924, Hoxhë Kadriu zgjidhet sërish Përfaqësues në Parlament, por këtë herë për Prefekturën e Kosovës, nga data 21 janar 1924 deri në 2 qershor 1924.

Në vitin 1921 Hoxhë Kadriu ishte kryetari i Partisë Përparimtare, partia opozitare, gjithashtu në qarqet politike të kohës ai është quajtur si përparimtar. Dhe sipas vlerësimit të historianëve, Bajram Curri, Hasan Prishtina dhe Hoxhë Kadriu luajtën një rol të rëndësishëm në rimëkëmbjen e shtetit shqiptar,²⁴ por njëkohësisht ata punuan për të shpëtuar territoret shqiptare të Kosovës nga shovinistët serbë, duke u përballur dhe me Ahmet Zogun, i cili ishte kundërshtar politik, i cili i përndoqi që të tre, pasi mori dhe konsolidoi pushtetin në 1925.

Më 20 janar 1925, në moshën 47 vjeçare, Hoxhë Kadri Halimi (Prishtina) ndërron jetë pas një sëmundje të rëndë, që e kishte zënë që në kohën kur ishte në burg.

Ky ishte një këndvështrimin nga "dritarja" që pak e kanë parë Hoxhë Kadriun, por për t'i kuptuar më së mirë idetë, parimet, besimin dhe veprimtarinë e Hoxhës, normalisht do të duhej një studim i hollësishëm i historisë së tij, i veprave dhe veprimtarisë së tij fetare, politike, intelektuale, bamirëse, sociale, etj.

23. Gazeta "KOHA" 25.12.1920 Viti XI i botimit nr.25; gjithashtu dhe nr.26 në vitin XII të botimit, 01.01.1921.

24. Arben Puto, Shqipëria Politike 1912-1939, f. 221, 325, Toena 2009, Tiranë.

Medreseja e Tiranës


NJË SHEKULL PËR ARSIMIN E DITURINË

Intelektuali i njohur, z. Xhemal Balla ish-medresist dhe më pas mësues flet për kushtet në të cilat u hap Medreseja e Tiranës në vitin e largët 1924, pedagogët dhe medresistët e parë si dhe rolin dhe kontributin e dhënë prej tyre në shoqërinë e asaj kohe e më vonë. Në vlerësimin e tij Medreseja e Tiranës ka qenë dhe mbetet një ndër shkollat elitë jo vetëm të kryeqytetit, por të gjithë Shqipërisë, pasi në bankat e saj janë përgatitur qindra studiues, inxhinierë, mjekë, mësues,

vaizë etj., që kanë punuar me ndërgjegje të lartë në sektorë të ndryshëm të jetës.

Z. Balla sjell në vëmendje momente nga rihapja e Medresesë në vitin 1991, ku edhe pse në kushte të vështira e mungesë të theksuar ambientesh e baze didaktike, Medreseja ruajti profilin e saj, duke ofruar për nxënësit e saj arsimin dhe edukimin e duhur të ndërthurur me frymën fetare e kombëtare, mision të cilin vazhdon ta kryejë me përkushtim edhe sot e kësaj dite.





Për medresetë, si institucione serioze të arsimit kombëtar fetar islam, mund të flasim vetëm në fillimet e shekullit XX, pas Shpalljes së Pavarësisë. Në ballë të tyre qëndron sigurisht Medreseja e Tiranës, që u hap më 1924 për të plotësuar nevojat për kadro fetarë. Cilat ishin kushtet në të cilat u hap kjo shkollë?

Pas shpalljes së pavarësisë klerikët shqiptarë radhiten bashkë me personalitete politike e shoqërore në mbrojtje të saj. Vehbi Dibra ishte zgjedhur në krye të pleqësisë, i ngarkuar nga Kuvendi me detyrën e Myftiut të përgjithshëm të Shqipërisë. Ai filloi menjëherë me riorganizimin e institucioneve fetare në Shqipëri e deri në ngritjen e zyrave të Sheriatit Islam. Këto probleme ai i bën objekt diskutimesh në mbledhjen e qeverisë së Vlorës, datë 5 maj 1913 (Arkivi Qendror, fondi 71, dosje 2, dokumenti 8135). Ndërmjet të tjerash në të shkruhej: "Myftinj të do të vihen në dispozicion të Hirësisë së tij, Shejhul Islam i Shqipërisë dhe funksioni i tyre do të dekretohet prej tij". Administrata fetare u krijua mbi baza të administratës shtetërore si p.sh. prefekturës i përgjigjej Myftiu, N/Prefekturës – N/Myftiu e me radhë, të gjitha në varësi të qeverisë. Një eveniment me rëndësi në vitin 1916 ishte krijimi i gjyqit të Naltë të Sheriatit Islam me kryetar Kryemyftiun e Shqipërisë H. Vehbi Dibra. Filloi reforma fetare e shoqërore, që arriti kulmin me ndarjen nga kalifati i Turqisë në vitin 1923, me organizimin e kongresit të parë mysliman më 24 shkurt deri 13 mars, kryesuar nga Dërvish Hima. Në këtë kohë pushteti i Ahmet Zogut kishte aprovuar masa ligjore që synonin kontrollin mbi bashkësitë fetare. Kongresi zgjodhi

komisionin për hartimin e statutit si dokumenti më i rëndësishëm i tij. Në nenin 6-7 përcaktohej zgjedhja e Këshillit të Naltë të Sheriatit Islam me kryetar Vehbi Dibra. Ky këshill ngarkohej që të ngrinte Medresenë e Naltë, si nevojë urgjente për Shqipërinë. Kjo u vendos në një kohë kur nuk ishte krijuar gjimnazi i Tiranës, por ekzistonte vetëm shkolla teknike.

Medreseja u hap në vitin 1924 me vendim të qeverisë shqiptare për efekt license. Në zbatim të artikullit 60 të statutit të Komunitetit Mysliman, Medreseja e Përgjithshme konsiderohej si një institut mësimor fetar e kombëtar, ku përfshinte tre kategori: fillore – lice – universitet, ku secila periudhë të ishte nga 4 vjet. Këshilli i Naltë i Sheriatit në fillim propozon hapjen e tri klasave për mungesë të godinës e anës financiare. Nga çdo prefekturë do të pranoheshin nga pesë nxënës, që u siguronin dhe financimin e tyre. Këshilli i Naltë emëroi si drejtor Qamil Balën, pjesëmarrës në kongresin islam dhe anëtar i Këshillit të Naltë të Sheriatit. Shkolla do të funksiononte me një rregullore të aprovuar prej 92 nenesh, me personel tërësisht shqiptar, me programe e organizim bashkëkohor të hartuar nga teologët e Komunitetit Mysliman.

Më 24.02.1924 u regjistruan 24 nxënës. Personeli arsimor ishte: Hafiz Ali Korça, mësues i gjuhës arabe; Sulejman Kadiu, mësues i Kur'anit, fikhut dhe gjuhës shqipe; Major Rexhep Berati, mësues i matematikë-gjeometri; kapiten Musa Puka, mësues i gjimnastikës; Haki Tefiku, mësues i histori-gjeografi; Pertef Pogoni, mësues i frëngjishtes; Jashar Qemali i higjienës; Qamil Bala i shkencës; Gani Strazimiri, mësues i vizatimit; doktor Sabriu, vizitë mjekësore javore. Në

semestrin e dytë, 01.09.1924 emërohen profesorë të rinj si Haxhi Tahiri, Haxhi Dashi, Sali Çela, Emin Jakova e Avni Zajmi.

Në kongresin e III islam që u mbajt më 6 korrik -3 gusht 1929 u vendos që Medreseja të emërtohej "Medrese e Përgjithshme", për shkak se u mbyllën medresetë e qarqeve. Në vitin 1931 përfundoi së ndërtuari godina e re e Medresesë dhe në inaugurimin e saj, në fjalën e hapjes foli politikani e sociologu shqiptar Mehdi Frashëri, ku ndërmjet të tjerash do të citonte: "Ky qe një sihariq për tërë botën islame shqiptare. Përparimi i vullshëm për ne shqiptarët është një nevojë e jetës. Medresetë do të jenë foleja e prijesve të fesë islame në Shqipëri, e duhet të konfirmohen me frymën e shekullit brenda të cilit jetojmë." (Zani i Naltë, Nr. 6, fq. 154-158)

Më 23.10. 1932 këshilli i përhershëm i Komunitetit Mysliman organizoi shpërndarjen e parë të 16 diplomave të studentëve, maturantëve të kësaj shkolle. Numri i nxënësve erdhi duke u shtuar saqë në vitin 1936 arriti në 100 nxënës të brendshëm dhe 25 nxënës të jashtëm. Evenimenti më i rëndësishëm ishte vizita e një ministri nga SHBA i shoqëruar nga kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar, dr. Behxhet Shapati.

Medreseja formoi fizionominë e një institucioni me vlera islame ku merrej formim i shëndoshë fetar e kombëtar, ndaj edhe fitoi emër të mirë në të gjithë vendin e më gjerë. Cili ka qenë profili i medresistëve të parë?

Profili i medresistëve të parë ka qenë i shkëlqyer. Kështu Shaban Demiraj nga Vlora mbaron me gradën "Lavdrueshëm" e arin të bëhet kryetar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë; Sali Ferhati, vaiz shëtitës në Berat e më vonë Myfti i Peshkopisë; Shefqet Jashari mësues feje e më vonë Myfti i Peqin-Shijak. Po kështu emërohen 8 maturantë vaizë shëtitës si: Enver Beqiri, Hafiz Sahiti, Limon Bushati, Shefqet Balla, Hasan Selami, Adem Mehmeti etj. Më datë 24.06.1939 të gjashtë maturantët shkojnë në Peruxhia të Italisë për të ndjekur kursin veror të gjuhës

italiane shoqëruar nga profesori i tyre. Studentët që mbaruan jashtë si Vexhi Demiraj në Kajro, renditet studenti i dytë që merr diplomën me rezultate të larta, emërohet në Medrese profesor i filozofisë në vitin 1939, zgjidhet sekretar i shoqatës bamirëse kulturore dhe e rinisë myslimane në kryeqytet dhe kryeredaktor i revistës "Arsyeja"; Sadik Bega diplomohet në Kajro, emërohet drejtor i revistës "Kultura Islame"; Sherif Putra diplomohet në Universitetin "Lahora" të Indisë dhe punësohet redaktor i revistës "Kultura Islame" e më vonë drejtor i Medresesë. Vexhi Buharaja fiton konkursin letrar të shpallur në fletoren "Tomorri" për prozë e poezi dhe bëhet një nga orientalistët më të shquar shqiptarë në përkthimin e mjaft veprave nga gjuhët e lindjes.

Cili është kontributi për shoqërinë i të diplomuarve në këtë institucion fetaro- arsimor?

Krahas detyrave fetare si imam, vaiz, myfti si dhe u përmend më lart, medresistët kanë kontribuar dhe në sektorë të ndryshëm të jetës civile-dominon profesioni i mësuesit, pasi një pjesë e konsiderueshme u diplomuan në Universitetin Shtetëror në degën e mësuesisë si: Sefer Bajraktari, Mehmet Balla, Mehmet Sinella, Ismail Muçej, Besim Ali Mehmeti etj, të diplomuar para çlirimit të vendit, ndërsa mbas vitit 1944, gjatë pushtetit komunist ka një numër më të madh medresistësh nga Kavaja, Durrësi, Tirana, Peshkopia që morën arsimin e lartë e kontribuuan në arsim, por edhe në degët e tjera të ekonomisë, që po të rendisim emra e kalojnë numrin 30. Në Tiranë Ibrahim Balla, Faik Kasollija, Ali Basha në Universitetin e Tiranës, Xhemal Balla, drejtor e inspektor arsimit, Ali Hoxha, Muhamed Xhimdulla, Fahri Doçi etj; në zonën e veriut, Hekuran Balliu, Idriz Xhaferri, Kujtim Gjinishi, drejtor arsimit, Zyhdë Çaçë etj.

Pas ardhjes së komunistëve në pushtet, si feja e besimi në përgjithësi, medreseja pati goditje me ashpërsi në rritje. A ka pasur raste ku profesorë apo medresistë janë persekutuar dhe burgosur nga regjimi totalitar?

Ardhja në pushtet e komunistëve solli reforma në fe dhe në përndjekjen e kuadrove të saj. Ekspozentë të shquar të klerit mysliman u persekutuan e u burgosën si: Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Ismet Dibra, Hafiz Sabri Koçi, Faik Hoxha, Ismail Muçej, Haki Sharofi, Jonuz Buliqi, Ibrahim Hasanaj, Haxhi Mustafa Varoshi, Hafiz Sherif Langu, Selim Gashi, Sheh Ali Pazari, Shyqyri Myftiu i ekzekutuar; Sheh Ibrahim Karbunara i pushkatuar etj, etj. U hoqën nga puna ose u burgosën të gjithë sepse dyshoheshin se ishin kundër pushtetit.

Mbas shpalljes së kushtetutës së re në mars të vitit 1946, shteti e ashpërsoi edhe më shumë luftën jo vetëm kundër klerit mysliman por edhe ndaj Medresesë. Ju hoq titulli Medrese e Naltë dhe u la





vetëm shkollë e mesme dhe vazhdoi të funksionojë sipas programit të shkollave profesionale kryesisht të pedagogjikes. Ministria e Arsimit gradualisht u përpoq që programi i shkollës të shkoj drejt laicizmit. Ministria e Drejtësisë me shkresë datë 27.01.1947 kërkon lirimin e xhamive për shkollën 7 vjeçare "Misto Mame". Gazeta "17 Nëntori", organ i Frontit Demokratik të Tiranës e datës 23.12.1946, boton artikullin me titull "Dhe mban akoma emrin shkollë!?". Ndërmjet të tjerash thuhet: "Thuhet se në medrese punohet sipas programit të Ministrisë. A mund të jetë e vërtetë kjo? Pse rrinë në Medrese 170 nxënës? Mos vallë u pëlqen?... Nxënësit kanë kërkuar suprimimin e Medresesë etj. etj. Kjo ishte një nxitje kundër Medresesë. Hoqi ditën e premte si ditë pushimi dhe e kaloi të dielën për të penguar faljen e ditës së premte.

Këshilli i Përgjithshëm në vitin 1953 me nxitje nga lart pushoi nga puna profesorët e medresesë si: Haki Narazani, Imer Saraçi, Jonuz Bulej, Selman Stërmasi etj. Në vitin 1964 me vendim Nr. 1 datë 22.08.1964, Këshilli i Përhershëm e mbyll Medresenë dhe ndalon propagandën fetare me urdhër nga lart.

Si ka qenë niveli i Medresesë së Tiranës gjatë periudhës së parë, krahasuar edhe me shkollat e tjera në kryeqytet?

Niveli i programeve dhe kërkesave ka qenë i lartë. Kanë dalë nxënës të shkëlqyer si Shaban demiraj, Vexhi demiraj, Vexhi Buharaja që kanë triumfuar në konkurset e organizuara me shkollat e qytetit. Këta kanë arritur grada të larta shkencore në jetën e tyre dhe i kanë shërbyer kombit.

Medreseja e Tiranës u rihap në vitet '90 kur në Shqipëri ishte lënë i lirë besimi, po ringjallej jeta fetare. Si e kujtoni rihapjen e saj?

Me ardhjen e demokracisë në vendin tonë, u rihap Medreseja në vitin 1991-1992 ku për bazë të lëndëve të kulturës së përgjithshme mori gjimnazin të aprovuar nga Ministria e Arsimit, me të drejtë që nxënësit të vazhdojnë studimet dhe në Universitetin Shtetëror.

Lëndët fetare përfshijnë: Kur'an, besim, histori islame, Akaid, Fikh, Usuli Fikh, Hadith, Tefsir, gjuhë arabe. Fillimet qenë shumë të vështira, pa baza didaktike dhe pa godinë. U përshtatën disa magazina pranë Xhamisë së Kokonozit, Tiranë. Gëzimi që i madh si nga ana e drejtuesve ashtu dhe e besimtarëve myslimanë. Ajo ditë u kthye në ditë feste. Bërthamën e personelit mysliman e bënë ish medresistët që ishin diplomuar në Universitetin e Tiranës dhe kishin punuar në arsim si: Ibrahim Balla (drejtor); Xhemal Balla (n/drejtor); Selim Stafa (arabisht); Ali Hoxha (arabisht e gjuhë letërsi); Hafiz Shaban Saliu, Ali Basha, Mehmet Sinella, Hekuran Balliu, Rrahman Balla, Ismet Tançica, Sadik Çollaku etj.

Cila ishte pritja që i bëri populli i Tiranës?

Gëzimi ishte i papërshkrueshëm. Besimtarë dhe intelektualë morën pjesë në rihapjen e saj. Tarik Llagami, ish drejtor i gjimnazit "Partizani" në Tiranë bënë një reportazh të bukur për hapjen dhe perspektivën e saj dhe rolin për përgatitjen e kuadrove fetare vendas. Baza materiale u sigurua me ndihmë nga shkollat e shtetit si "Fan Noli" e ndonjë tjetër. Ajo funksionoi me seriozitetin më të madh në zbatimin e programeve mësimore derisa krijohen mundësitë për të kaluar në ish godinën e saj të zaptuar nga shëndetësia me fakultetin stomatologjik.

Ju jeni një kuadër i vjetër e me përvojë të gjatë, sipas jush cilat janë përparësitë e Medresesë në krahasim me institucionet e tjera arsimore të sistemit parauniversitar?

Dallimi qëndron vetëm në futjen e programit të disa lëndëve fetare islame, që e formojnë nxënësin nga ana e besimit. Ndërsa lëndët e kulturës së përgjithshme janë të barabarta me programin e gjimnazit shtetëror dhe nxënësi që mbaron këtë shkollë nga parimi edukativ-themelor është i barabartë me ta dhe nuk ka asnjë pengesë për të vazhduar shkollën e lartë si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij.

Në vitet e para Medreseja provoi vështirësi të mëdha e serioze që i kapërceu gradualisht, duke filluar nga mungesa e ndërtesës e mjeteve didaktike-mësimore, kuadri i kualifikuar mësimdhënës, programet e deri te tekstet mësimore aq të nevojshme. Ç'mund të na thoni për medresenë sot?

Sot Medreseja radhitet ndër shkollat më të mira me programe e bazë didaktike bashkëkohore, që i plotëson nevojat e zbatimit të programeve me laboratorë përkatëse si biologji-kimi, fizikë, gjuhë të huaja, informatikë etj. Kjo shkollë e ka afirmuar veten me pjesëmarrjen e nxënësve të saj në konkurse brenda vendit krahas shkollave të tjera si dhe jashtë vendit duke fituar çmime të vendeve të para, të dyta e të treta.

Nxënësit e ndiejnë veten të privilegjuar që vazhdojnë këtë shkollë.

Fatime Zehra

MODEL I VAJZËS, GRUAS DHE NËNËS MYSLIMANE



Të gjithë kombet e popujt e ndryshëm, sipas rastit e vendit, festojnë ditëlindjen e njerëzve të tyre me zë, të dalluar për vepra trimërie, bamirësie, letrare, filozofike e shkencore, duke i shërbyer jo vetëm kombeve përkatëse, por edhe mbarë njerëzimit. Këta njerëz të mëdhenj, jo vetëm i kanë sjellë dobi e përfitim popujve të ndryshëm, por bëhen më vonë shembuj për brezat e ardhshëm që të shkelin në gjurmët e tyre. Në historinë Islame ka ngjarje e përkujtime që nuk duhet të harrohen kurrë. Ato duhet të vlerësohen e të ngrihen lart, pasi në festimin e tyre marrim forcë të re. Një nga këta përkujtime është festimi i ditëlindjes së vajzës së profetit tonë të nderuar Fatime Zehra (r.anha).

Fatimja, Zoti qoftë i kënaqur prej saj, erdhi në jetë nga dy prindër të mrekullueshëm, Profeti Muhamed (a.s.) dhe gruaja e tij Hz. Hatixhe (r.anha). Rritja dhe prania e Fatimes pranë babait profet dhe zonjës së madhe Hatixhe, bënë që vajza e tyre të arrijë një shkallë të lartë në besim, dituri dhe përkushtim. Prindërit e saj punuan shumë për edukimin e Fatimes që ta stolisin atë me virtyte të bukura. Ajo u edukua me cilësi të larta profetike të babait të saj, ku dalluan dashuria, respekti, humanizmi dhe bindja e thellë te Krijuesi i gjithësisë. Ndërkohë që nëna përpiquej të ndriçonte mendjen e saj me dituri dhe hijeshi në sjellje, babai i saj i mësonte citime kuranore që kishin të bënin me besimin te Zoti, me sjelljen dhe ligjet e zhvillimit të shoqërisë. Me kalimin e kohës, te Fatimja filluan të shfaqeshin frytet e para të sinqeritetit, durimit, çiltërsisë, optimizmit, frymëzimit dhe gëzimit që u dhuronte njerëzve.

Fatimja ishte një vajzë e zgjuar, e këndshme dhe gazmore. Bota e saj e pasur me emocione, e bënte atë shumë të ndjeshme përballë ngjarjeve të hidhura, sidomos kur këto ngjarje kishin të bënin me babin e saj. Ajo tmerrohej kur dëgjonte lajme që do të vrisnin profetin apo kur merrte vesh për njerëz të pafajshëm që ishin marrë peng, torturoheshin apo vriteshin për shkak se kishin pranuar fenë islame. Gjatë fazave të jetës, ajo u përball me frikën, tiraninë, humbjet, varfërinë dhe dhimbjet që Zoti i Lartësuar kishte përcaktuar në kaderin e saj. Me këto përjetime e vuajtje, te shpirti i saj u zgjua forca e vetëmohimit, sakrificës, ndershmërisë dhe e rezistencës në përballimin e vështirësive të ndryshme. Fatimja asnjëherë nuk u ankua për vuajtjet e

mundimet që përjetonte, por përpiquej të ishte e gëzuar dhe të jepte shpresë. Ajo e shihte se si mbrojtësit e familjes së profetit kishin dhënë prova të guximit dhe sakrificës së tyre për dashurinë dhe mirësinë ndaj profetit të Zotit, Muhamedin (a.s.)

Me gjithë sprovat e ndryshme, Profeti ynë i nderuar e qetësonte gjithmonë Fatimen dhe e bënte të qeshte e të gëzohej. Kjo u vu re madje edhe në momentet e fundit të jetës së profetit tonë, kur ai i tha diçka asaj dhe ajo në fillim qau, por kur pastaj i tha diçka tjetër, ajo u gëzua dhe qeshi. Ajo qau në fillim kur mori vesh nga profeti që do të ikë nga kjo botë, dhe u gëzua kur ai i tha se do të ishte ajo e para që do ta takonte në botën tjetër. Profeti (a.s.) për të ka thënë: "Pa dyshim që vajza ime, Fatimja është zonja e të gjitha grave. Ajo është pjesë e imja dhe drita e syve të mi. Ajo është lulja e zemrës sime dhe e shpirtit tim". Profeti ynë i nderuar e martoi vajzën me mashkullin e parë që pranoi islamin, nipin e tij Hz. Aliun (r.a.). Kështu që Fatimja ishte më se e kënaqur dhe e gëzuar, sepse rrethohej nga meshkujt më të mirë të botës, me babin e saj të përkryer profetin Muhamed (a.s.) dhe burrin e saj të lartësuar në virtyte, Hz. Aliun, Zoti qoftë i kënaqur prej tij.

Si grua dhe bashkëshorte, Fatimja mbajti barrën dhe përgjegjësinë e ndërtimit të një jete të qetë e të lumtur. Allahu i Madhërishëm ia shpërbleu duke i dhuruar dy djem të përkushtuar dhe të devotshëm, Hasanin dhe Hysejnin, si dhe dy vajza të mrekullueshme Zejnebin dhe Ummu Kulthum, të cilët patën fatin të edukoheshin edhe nën prehrin e ngrohtë të gjyshit të tyre, Profetit Muhamed (a.s.). Fatime Zehra i dhuroi familjes së vet dashuri, butësi, mirësi dhe harmoni. Ajo ishte një nënë e dashur, e dhembshur dhe fisnike, e cila i rriti me një bujari shpirtërore fëmijët e saj, duke dhënë një përkujdesje totale për një edukim të mirëfilltë të tyre. Familja e saj edhe pse ishte e thjeshtë dhe e varfër, aty gjendej, besimi, dashuria, morali i lartë, respekti, dhembshuria, solidariteti dhe humanizmi. Me qëndrimin, sjelljen dhe peshën e fjalës, në çdo rast, Fatimja përcolli respektin tek të gjithë ata që e rrethonin. Fatime Zehra (Zoti qoftë i kënaqur prej saj) është modeli i plotë i femrës myslimane. Nga sjellja e saj duhet të frymëzohen sidomos gratë, sepse rreth saj ishin të kristalizuar të gjitha llojet e sakrificës, mirësisë, adhurimit, durimit dhe spiritualitetit të lartë.

Zhvillimi i *trurit* gjatë adoleshencës

Deri kohët e fundit, truri i njeriut mendohej se përfundonte zhvillimin e tij në një masë të madhe kur fëmija është 5 ose 6 vjeç. Kjo ishte kryesisht teorike, sepse ne nuk kishim teknologjinë për të vizualizuar trurin e një personi të gjallë në mënyrë që të vëzhgojmë zhvillimin e tij. Kjo ndryshoi me zbulimin e teknikës së rezonancës magnetike (MRI), e cila filloi të përdoret në aplikime të ndryshme në vitet 1970 dhe na mundësoi të marrim informacion më të qartë në lidhje me strukturën dhe funksionet e trurit. Që nga viti 1991, falë teknikës funksionale MR (fMRI) ne tani jemi në gjendje të vëzhgojmë aktivitetet e një truri të gjallë. Teknologjia fMRI përdoret për të skanuar dhe vizualizuar rajonin specifik të trurit që aktivizohet përballë stimuljeve të tillë si zhurma, shikimi dhe mendimi. Prandaj, hulumtimi i fMRI i kryer gjatë dhjetë viteve të fundit ka udhëhequr studimet kërkimore mbi atë se si ndodhin kujtesa, gjuha, dhimbja dhe të mësuarit, si dhe ato se si emocionet formohen me perspektiva të reja. Zbulimet e reja në lidhje me trurin e adoleshentëve kanë ndryshuar rrënjësisht të kuptuarit tonë se si mësojnë nxënësit e moshës 11-18 vjeç.

Adoleshenca është një proces domethënës në të cilin përjetohen ndryshime të mëdha si fizikisht ashtu edhe mendërisht. Struktura dhe përmbajtja e substancës së trurit ashtu edhe në tru, rikonstruktohen gjatë kësaj periudhe. Njohja e ndryshimeve të përjetuara nga truri i adoleshentëve gjatë kësaj periudhe do të jetë shumë e dobishme si për prindërit ashtu edhe për mësuesit, pasi

ata mbështesin fëmijët dhe studentët e tyre në rritjen dhe zgjidhjen e karakterit të tyre.

Lënda e bardhë

Lënda e bardhë në tru përbëhet kryesisht nga aksone të mielinizuara dhe qeliza gliale. Aksoni është një projeksion i gjatë dhe i hollë i një neuroni (qeliza nervore). Mielina është një shtresë e bardhë e një mbështjellësi të dendur yndyror që rrethon një akson. Formimi i mbështjelljes së mielinës quhet mielinizim. Qelizat gliale në trupin e njeriut janë më të shumta se neuronet dhe megjithëse nuk transmetojnë sinjale elektrike ato kanë funksione thelbësore duke prodhuar dhe mirëmbajtur mjedisin që neuronet të funksionojnë siç duhet. Një nga funksionet e tyre është shkatërrimi dhe heqja e kimikateve të dëmshme dhe neuronet e vdekura. Qelizat gliale gjithashtu luajnë një rol aktiv në mielinizim. Sinjalet elektrike në terminalet e aksoneve transmetohen tek neuronet e tjera në kryqëzimet e quajtura sinapse. Nuk ka asnjë kontakt fizik midis shumicës së neuroneve, prandaj mesazhi në sinapset transmetohet kimikisht tek neuronet e tjera përmes neurotransmetuesve. Një akson i mielinizuar transmeton sinjale elektrike me një ritëm 100 herë më shpejt se ai i pa mielinizuar dhe mbështjellja e mielinës ndihmon një neuron të rigjenerohet më shpejt. Me fjalë të tjera, ajo rikthehet në një mënyrë dukshëm më të shpejtë në një gjendje në të cilën transmeton një sinjal të ri elektrik. Pasi të kombinohen këto dy veçori, kjo rezulton

në një rritje 3000 herë në shpejtësi nëse krahasojmë një akson të mielinizuar me një kablo interneti. Një funksion tjetër i mbështjelljes së mielinës është të kalibrojë koordinimin e sinjaleve që vijnë nga neuronet e tjera. Ai lejon një kohë optimale të transmetimeve në mënyrë që sinjalet që vijnë nga neuronet që janë afër dhe larg mund të merren njëkohësisht. Si rezultat i mielinizimit, sasia e lëndës së bardhë vazhdon të rritet në mënyrë lineare gjatë adoleshencës deri në fund të viteve 20. Adolehentët, pra, përpunojnë informacionin në një mënyrë shumë më të shpejtë se ajo e fëmijëve dhe kështu mund të lëvizin, flasin, marrin vendime dhe reagojnë më shpejt.

Lënda gri

Lënda gri është e përbërë kryesisht nga trupat e qelizave neuronale, dendritet (shtrirjet e shkurtra të trupit) dhe qelizat mbështetëse. Ajo gjithashtu përmban lidhjet që lidhin neuronet me neuronet e tjera, të njohura si sinapset. Truri i një fëmije ka deri në dy herë më shumë sinapse sesa do të ketë në moshën e rritur. Një total prej 60% e energjisë së foshnjave përdoret nga truri i tyre krahasuar me rreth 20-25% në të rriturit. Vëllimi i lëndës gri fillon të ulet seriozisht gjatë adoleshencës dhe kjo rënie mund t'i atribuohet një procesi të quajtur "krasitje sinaptike". Përmes këtij procesi, lidhjet nervore që nuk përdoren ose stimulohen nga faktorët mjedisorë shkurtohen dhe eliminohen. Edhe pse kjo tingëllon si një proces negativ, përkundrazi, është thelbësor për një tru më efikas. Lidhjet që janë të padëshiruara dhe të papërdorura shkatërrohen. Ky është një proces shumë domethënës që ndikohet pjesërisht nga mjedisi ekzistues i dikujt me një efekt të qëndrueshëm në formimin e jetës së një personi. Një rritje e lëndës gri ndodh për një afat të shkurtër vetëm në fillim të adoleshencës. Një krasitje e dytë sinaptike ndodh më vonë gjatë adoleshencës. Kjo ndodh më shpesh në rajonin e korteksit prefrontal të trurit. Ky rajon është përfshirë me shumë funksione domethënëse dhe vitale të trurit, të tilla si planifikimi, vendimmarrja, përcaktimi i prioriteteve, formulimi i strategjisë, shtypja e dëshirave, vonimi i kënaqësisë, kuptimi i të tjerëve dhe ruajtja e ndërveprimit shoqëror, dhe vendosja e synimeve afatgjata.

Një fakt biologjik që do të na ndihmojë të kuptojmë pak më shumë adolehentët përfshin faktin se mielinizimi dhe zhvillimi i trurit ndodhin në një model të kundërt. Kjo do të thotë, korteksi parabolli, i cili kontrollon funksionet që përfshijnë këto tipare vitale dhe të rritura, zhvillohet e fundit dhe kjo korrespondon me vitet e jetës pas moshës 20 vjeç.

Mjedisi shoqëror i dikujt kontribuon ndjeshëm në krasitjen sinaptike dhe rregullimin e strukturës morfologjike të trurit. Një dimension që mund t'i shtojmë këtij fakti është se fëmijët nuk kanë nevojë vetëm për mjedise të përshtatshme fizike, por gjithashtu kanë nevojë për mjedise shpirtërore ku ata mund të zhvillojnë dhe

realizojnë jetën e tyre shpirtërore, të ndiejnë njerëzimin e tyre dhe të krijojnë marrëdhënie të përzemërta me Allahun xh.sh.

Burimi i problemeve të adoleshencës: Sistemi limbik

Pjesët integruese të sistemit limbik, ose siç njihet gjerësisht si "truri emocional", janë hipokampusi, amigdala, talamus dhe hipotalamus. Hipokampusi është qendra e emocioneve dhe një pjesë e rëndësishme e kujtesës. Amigdala, nga ana tjetër, është qendra për ndjenja të forta të tilla si zemërimi, frika, gëzimi dhe kënaqësia. Sistemi limbik është rajoni i trurit që kontrollon shumicën e emocioneve dhe sjelljeve që qëndrojnë në themel të problemeve dhe karakteristikave themelore të adolehentëve, të tilla si marrja e rrezikut bazë, motivimi, uria, gjumi, kujtesa afatgjatë, kërkimi i eksitimit, kërkimi i shpërblimit, kërkimi i rrisë, superioriteti i shprehjes emocionale dhe përparësia e nevojave të menjëhershme. Siç është thënë tashmë, truri piqet nga mbrapa në pjesën e përparme. Kjo do të thotë, ndërsa zhvillimi i sistemit limbik është i plotë deri në adoleshencë, korteksi parabolli ende nuk është zhvilluar plotësisht. Nëse e krahasojmë sistemin limbik me pedalin e gazit të një makine, atëherë korteksi parabolli mund të krahasohet si me timonin e tij ashtu edhe me pedalin e tij të frenave. Kjo do të thotë, adolehentët janë si një makinë me pedalin e gazit të shtypur plotësisht, por timoni dhe pedali i frenave nuk punojnë ende plotësisht. Studimet kanë gjetur se në trurin e adolehentëve bërthama e akumuluar, rajoni i trurit i lidhur me shpërblimin, motivimin dhe kënaqësinë, është shumë më i aktivizuar përballë shpërblimeve të mëdha në krahasim me trurin e fëmijëve dhe të rriturve. Sidoqoftë, ndikimet e shpërblimeve ose synimeve të vogla ose jo interesante janë edhe më pak në trurin e adolehentëve sesa në trurin e një fëmije. Unë pretendoj se kjo është një çështje në të cilën prindërit dhe mësuesit duhet të ndalen.

Studimet kanë treguar gjithashtu se adolehentët kanë tendencë të ndërmarrin rreziqe më të mëdha në mjedise ku bashkëmoshatarët e tyre janë të pranishëm. Është gjetur se adolehentët mund të mendojnë po aq pjekur sa të rriturit në mjedis laboratorik, domethënë në kushte neutrale ku emocionet nuk ndërhyjnë. Sidoqoftë, kjo ndryshon plotësisht në prani të ndërhyrjes emocionale, presionit të bashkëmoshatarëve ose faktorëve të tjerë që lidhen me moshatarët.

Hulumtimi i trurit ka zbuluar se truri i të rinjve ka tendencë të ndryshojë në përputhje me ndërhyrjet e jashtme, edukimin dhe rehabilitimin që u ofrohet. Mjedisi, i cili gjithashtu përfshin arsimin, mund të luajë një rol të rëndësishëm në formimin e trurit të një individi të ri. Informacioni i ri dhe zhvillimet në lidhje me zhvillimin e trurit kanë sjellë ndryshime rrënjësore në fushat e arsimit dhe pedagogjisë. Teoritë e reja të të mësuarit kërkonjne gjithashtu zhvillimin e teknikave të reja dhe alternative të mësimdhënies që janë në përputhje me modelin e zhvillimit të trurit.

Faleminderit Zoti im

Faleminderit Zoti im, që më solle në këtë botë.
Jam i lumtur që mund të dëgjoj, shijoj, prek dhe shoh gjithçka.
Zoti im, më jep shëndet dhe më bëj prej njerëzve që Ti do.
Të lutem, Zoti im, më jep mua dhe njerëzve që dua një jetë të gjatë.

Faleminderit Zoti im, që më ke dhënë një nënë të mrekullueshme.
Mami im gatuan ushqime shumë të shijshme.
Ajo qëndron gjithmonë me mua kur jam i sëmurë e në krahët e saj ndihem i sigurt.
Më pëlqen shumë aroma e saj.
Zoti im, lejo që nëna ime të jetë gjithmonë me mua.

Faleminderit Zoti im, që më ke dhënë një baba të fortë dhe punëtor.
Zakonisht ai vjen vonë dhe shumë i lodhur nga puna, por gjithmonë gjen kohë për mua.
Unë e dua shumë atë dhe ndonjëherë i bëj surpriza.
Të lutem, lejo që ai të jetë gjithmonë me mua.
Zoti im, jepi forcë babait tim.

Faleminderit Zoti im, që më ke dhënë një motër të vogël e të bukur.
Para se të lindej ajo, mendoja se prindërit nuk do të më donin më, por e kisha gabim.
Hunda e motrës sime është njësoj si hunda ime.
Jam shumë i lumtur kur luaj me të.
Zoti im, dua që të jem gjithmonë me motrën time.
Nuk dua të ndahem kurrë prej saj.

Faleminderit Zoti im, për gjyshen dhe gjyshin.
Gëzohem shumë kur ata më marrin në prehër e më përqafojnë.
Unë i dua shumë gjyshërit e mi, e mërzitem kur ata sëmuren.
Zoti im, jepu gjyshes e gjyshit jetë të gjatë e të shëndetshme.

Faleminderit Zoti im, që mua dhe familjes sime na ke dhënë një shtëpi.
Unë e dua shumë shtëpinë tonë dhe dhomën time.
Shtëpia jonë është shumë e ngrohtë e në të kemi gjithçka që na nevojitet.
Ndihej i sigurt kur jam në shtëpi.
Zoti im, ndihmoji fëmijët që nuk kanë një strehë.
Jepu atyre një shtëpi të ngrohtë ku mund të jetojnë.

Faleminderit Zoti im...



SHËRBIM 24 ORË

**“Secili njeri do ta shijoj
vdekjen, e shpërblimet
tuaja u plotësohen Ditën
e Kiametit, e kush shmanget
zjarrit e futet në xhenet,
ai ka arritur shpëtim, e jeta
e kësaj bote nuk është
tjetër, pos një përjetim
mashtrues.”.**

(ALI IMRAN, 185)

MYFTINIA E TIRANËS OFRON
Shërbime Funerale

Cel: 0694077725
0682532211

Email: funeral.myftiniatirane@kmsb.al

ADRESA: Rruga Odhise Paskali, Sheshi Shtraus (Xhamlliku), Tiranë 1001



WWW.MYFTINIAETIRANES.COM

